REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org Unit: AJPMNP Nr. Prot. / Br. Prot / Prot. No: 503
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: / Data / Datum / Date: 14.03.2013
PRISHTINË/A

Nr. 172 Dt. 14/03/2013
PRISHTINË-A

# KOSTT

# Raport Vjetor 2012

## (01.01.2012-31.12.2012)

| | Përgatiti | Kontrolloi | Aprovoi |
|---|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Nebih Haziri | Fadil Ismajli KSHE | U.d. Kryesuesi i BD Ramadan Paçarada |
| Nënshkrimi | | | |
| Data | *6 Mars. 2013* | *6 Mars, 2013* | *6 Mars, 2013* |

**Raport Vjetor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT**
**Periudha Janar - Dhjetor 2012**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | **Titulli i Dokumentit** | Raport Vjetor 2012 |
| 2 | **Dërguesi i dokumentit** | **Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv** |
| 3 | **Përmbajtja e Raportit** | Përmbajtja<br>**Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT**<br>**Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT**<br><br>**1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve**<br>1.1. Aktivitete kryesore të ndërmara gjatë vitit<br>1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja<br>1.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv<br>1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual<br>1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funcionimin e KOSTT-it<br>1.6. Pasqyrë e të priturave për vitin e ardhshëm<br>1.7. Infomacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën<br>1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit<br><br>**2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv**<br>2.1. Arritjet kryesore<br>2.2. Ngjarjet kryesore të vitit<br>2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës<br>2.3.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2012<br>2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit<br>2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit<br>2.3.4. Operimi i tregut<br>2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet<br>2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare<br><br>2.4. Progresi me planin e biznesit<br>2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2012<br><br>2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm<br>2.7. Rreziqet |

| | | |
|---|---|---|
| | | **Anekset**<br><br>**1. Sponzorimet dhe donacionet**<br>**2. Raporti i Zyrtarit për Auditim të Brendshëm**<br>**3. Formulari i Vetëvlerësimit të Bordit**<br><br>**4. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike**<br>4.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit<br>4.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore<br>4.3. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë vitit 2012 nga burimet e KOSTT<br>4.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës<br><br>**Lista e shkurtesave** |
| 4 | Data e Raportimit | |

# Hyrje

Raporti Vjetor i vitit 2012 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, sipas të cilit, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, Raporti dërgohet në Njësinë për Politika dhe Monitorim të NP-ve.

Ky Raport është punuar sipas formës së re të aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike dhe sipas "Udhëzuesit për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike".

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2012 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

# Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të KOSTT-it

Për KOSTT viti 2012 shënon vazhdimin e zhvillimeve pozitive në të gjitha aspektet e performancës së kompanisë. Përgjatë kësaj periudhe, Bordi i Drejtorëve ka luajtur një rol proaktiv duke mbështetur menaxhmentin në realizimin e objektivave të përcaktuara me dokumentet e kompanisë dhe duke zbatuar detyrat fiduciare të përcaktuara me ligjet në fuqi.

KOSTT ka vazhduar punën në drejtim të përmbushjes së objektivave afariste dhe vizionit për të qenë një kompani e vetëqëndrueshme financiarisht dhe duke ofruar shërbime kualitative për klientët e vet.

Pra, KOSTT me sukses ka realizuar planin e biznesit duke implementuar projektet e parashikuara, e të cilat kanë rezultuar me performancë më të mirë teknike, humbje më të vogla dhe furnizim më kualitativ për klientët dhe të gjitha këto, duke respektuar standardet më të larta profesionale në zbatim. KOSTT gjithashtu ka realizuar efiçiencat e çmimit të kërkuara nga ZRrE dhe si rezultat profit të zvogluar krahasuar me periudhat e kaluara, respektivisht kosto relative më të vogël që konsumatorët kanë paguar për shërbime të transmisionit.

Në anën tjetër, KOSTT ka qenë shumë aktiv në revidimin dhe konsolidimin e kornizës ligjore dhe rregullative e cila i përket sferës së vet. Të gjitha këto, pa lënë anash planifikimin e zhvillimit të ardhshëm të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore, e të cilat janë parakushte të suksesit, që fuqishëm besoj se do të dëshmohet edhe për periudhën e ardhshme.

Ramadan Paçarada
U.d. Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KOSTT sh.a.

# Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT

Është e njohur se në sektorin e energjisë elektrike rezultatet e angazhimit nuk vërehen menjëherë, dhe në këtë aspekt kemi kënaqësinë që të prezantojmë të arriturat e realizuara gjatë kësaj periudhe. Kështu që ky Raport ofron një retrospektivë të qartë të punës së kaluar që nxjerrë në pah rezultatet e punës dhe planifikimit të bërë gjatë periudhës së kaluar.

Si edhe në vitet e mëparshme, arritjet e KOSTT-it janë rezultat i angazhimit të mirëfilltë të të gjithë punëtorëve dhe ekipit tonë menaxherial, por që u kurorëzuan me sukses falë mbështetjes institucionale dhe financiare nga aksionari, palët e interesit si dhe qasjes profesionale të Bordit të Drejtorëve në qeverisjen korporative.

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit është një ndër detyrat kryesore të KOSTT. Gjatë vitit 2012 janë realizuar projekte të rëndësishme të cilat kanë kontribuar në përmbushjen e kësaj detyre. Janë ndërmarrë shumë aktivitete në implementimin e projekteve të reja dhe përfundimin e projekteve në vazhdim siç janë ngarkimi i nënstacionit NS 400/110 kV–Ferizaj 2, bashkë me linjat ndërlidhëse transmetuese 400 dhe 110 kV, rindërtimi i nënstacionit 220/110 kV NS Prizreni 2 dhe implementimi i platformës së teknologjisë informative për tregun e energjisë elektrike (ka vazhduar rritja e shkallës së shfrytëzimit të SCADA/EMS), ndërsa në anën tjetër, KOSTT mbetet i zotuar ta përfundojë në mënyrë sa më të shpejtë dhe kualitative projektin për ndërtimin e linjës 400 kV Kosovë – Shqipëri, i cili ndjeshëm do të kontribuojë në optimizimin e sistemeve të të dy vendeve dhe zhvillimit ekonomik.

Implementimi i suksesshëm i këtyre projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të vendosura nga KOSTT, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat teknike që dalin nga aktetet e ENTSO-E.

Performanca e operimit të sistemit të transmisionit në vitin 2012 ka pasur ngritje të theksuar. Vlen të përmenden disa nga indikatorët themelorë të kësaj performance. Në radhë të parë, edhe pse piku është rritur vazhdimisht, sistemi transmetues ka përcjellë zhvillimin e ngarkesës dhe ka mundësuar furnizim me energji elektrike me parametra kualitativ, duke mos cenuar shkallën e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit;
Por, padyshim, reduktimi i dukshëm i humbjeve të energjisë elektrike në vitin 2012 për 5.9% krahasuar me humbjet e realizuara në vitin paraprak, paraqet një ndër performancat më të rëndësishme të sistemit. Kjo tregon se investimet në rritjen e kapaciteteve të transmisionit, modernizimi i sistemit dhe mirëmbajtja preventive, kanë ndikuar në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, gjë që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Të gjitha këto rezultate janë evidente, dhe si të tilla vlerësohen lartë edhe nga rrethina afariste e KOSTT. Për më tepër, KOSTT ka vazhduar angazhimin dhe përgatitjet për të mbështetur projektet për privatizimin e KEK Shpërndarjes dhe Furnizimit dhe projektin për termocentralin Kosova e Re , duke përgatitur infrastrukturën e sistemit të transmisionit,kornizën teknike përkatëse rregullative si dhe ngritjen e shkathtësive të stafit për të ballafaquar me këto procese. Po ashtu, KOSTT mbetet i zotuar për ofrimin e qasjes së barabartë në rrjet për të gjithë përdoruesit e sistemit, si dhe mbështetjen për integrimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, në bazë të rregullave të miratuara nga ZRrE.

Edhe për vitin 2011, për të gjashtën herë radhazi, raporti i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare është pa asnjë kualifikim, që reflekton punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve të KOSTT.

Falë angazhimit dhe profesionalizmit të të gjithë punëtorëve, KOSTT ka vazhduar të dëshmojë përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta profesionale. Është fjala për çertifikimin për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008 me të cilën KOSTT është riçertifikuar në vitin 2012.

Si edhe deri më tani, do të vazhdojmë me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në rradhë të parë me aksionarët tonë ( Qeverinë e Kosovës), me palët e interesuara e posaçërisht me ZRrE, donatorët (Komisioni Evropian, KfW, USAID, etj), OST-të fqinje dhe më gjërë, por edhe me institucionet financiare relevante.

KOSTT është dhe mbetet edhe më tutje i përkushtuar për të dhënë kontributin e vet në përshpejtimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Kosovës, në ruajtjen dhe krijimin e vlerave të reja në sistemin elektroenergjetik dhe në dobi të vendit.
Përpjekjet tona të vazhdueshme, do të jenë të orientuara drejt përmbushjes së synimeve tona shumë qartë të përcaktuara, zhvillimit dhe punës tonë dhe përgatitjes për një të ardhme të dimensionit evropian.

Fadil Ismajli,
Kryeshefi Ekzekutiv

# 1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve

## 1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012 KOSTT-i ka zhvilluar aktivitete të ndryshme të qeverisjes korporative bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Aktivitetet kryesore në këtë aspekt përfshijnë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera që Bordi i ka themeluar për nevojat e KOSTT-it.

Procesverbalet nga mbledhjet e Bordit, të Komisionit të Auditimit dhe të Komisioneve të tjera, raportimi dhe dërgimi i infomatave Njësisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) siç kërkohen sipas nenit 31, 32 dhe 37 të Ligjit për NP, janë kryer në mënyrë të rregullt dhe sipas afateve ligjore. Gjatë vitit 2012 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka mbajtur gjithësejt 10 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të zakonshme dhe përfshijnë: Vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit të Drejtorëve, Shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera dhe Informatën rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv (KE) të KOSTT-it.

Në çdo mbledhje Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e Komisionit të auditimit dhe rekomandimet, si dhe raportet e Komisioneve të tjera siç janë: Komisioni i Projekteve kapitale, Komisioni për projektin e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri dhe Komisioni për ndarjen e aseteve KEK-KOSTT.
Në mbledhjen 31-të të Bordit të Drejtorëve të datës 28.08.2012 në pajtim me Udhëzimin nga aksionari, Bordi morri vendim për anulimin e të gjitha vendimeve për themelimin e komisioneve të përkohshme të Bordit.
Ndërsa, në mbledhjen e 32-të të datës 23.10.2012 Bordi i Drejtorëve të KOSTT pas pëlqimit të dhënë nga aksionari ka themeluar edhe tri komisione të përkohshme të cilat janë në funksion të ofrimit të ndihmës dhe informatave më të hollësishme për Bordin e Drejtorëve rreth aktiviteteve të veçanta. Komisionet e themeluara janë:

**Komisioni për investime kapitale**
1. Nazmi Mikullovci, Kryesues
2. Ramadan Paçarada, Anëtar
3. Lutfi Maxhuni, Anëtar

**II. Komisioni për operim**
1. Fatos Ukaj, Kryesues
2. Nazmi Mikullovci, Anëtar
3. Ramadan Paçarada, Anëtar

**III. Komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore**
1. Lutfi Maxhuni, Kryesues
2. Fatos Ukaj, Anëtar
3. Faton Deda, Anëtar

Raportet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të themeluara nga Bordi janë prezantuar si materiale në mbledhjet e Bordit dhe janë dërguar në NJPMNP.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur vendimet kryesore që janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2012 duke mos i përfshirë mbledhjet dhe konsultimet e Zyrtarëve të Kompanisë, respektivisht Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar, Sekretarit të Kompanisë dhe Auditorit të Brendshëm me Bordin dhe Zyrtarët e Njësisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike, raportimet dhe aktivitet e ngjashme korporative.

| Nr. | **Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:** |
|---|---|
| 1 | Raport tremujor për periudhën Tetor –Dhjetor 2011,<br>Raport tremujor për periudhën Janar – Mars 2012,<br>Raport tremujor për periudhën Prill-Qershor 2012 dhe<br>Raport tremujor për periudhën Korrik-Shtator 2012 (bazuar në nenin 31 të Ligjit për NP) |
| 2 | Raporti i Komisionit për regjistrimin e pasurisë të KOSTT-it për vitin 2011 (Elaborati i regjistrimit të aseteve) |
| 3 | Plani i punës së Bordit të Drejtorëve (BtD) dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2012 |
| 4 | Raporti Vjetor i punës së KOSTT-it për vitin 2011 |
| 5 | Rregullorja për pagesën e shërbimeve komunale |
| 6 | Marrëveshja për kufirin e ri ndarës KOSTT-KEK |
| 7 | Politika për praktikën profesionale në KOSTT |
| 8 | Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare Rregullative për vitin 2011 |
| 9 | Plani i Bizensit i reviduar për vitin 2012 |
| 10 | Vendimi për anulimin e te gjitha vendimeve per themelimin e komisioneve të përkohshme të Bordit të Drejtorëve |
| 11 | Plani i Prokurimit për vitin 2013 |
| 12 | Propozimi dhe Vendimi për themelimin e Komisioneve të përkohshme të Bordit të Drejtorëve |
| 13 | Vendimi për Emërimin e Sekretarit të Kompanisë |

### 1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja

Gjatë vitit 2012 Komisioni i Auditimit ka vlerësuar të gjitha raportet tremujore, raportin vjetor të vitit 2011, Raportin e Auditorit të Jashtëm në KOSTT, raportet e auditorit të brendshëm, propozim Buxhetin për vitin 2012, revidimin e buxhetit për vitin 2012, Planin e Biznesit për vitin 2012, politikat, Planin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2013, Planin e prokurimit dhe raporte të tjera.
Komisioni i Auditimit ka mbajtur 10 mbledhje.

Komisioni për projektet kapitale ka mbajtur 3 (tri) mbledhje.
Komisioni për linjën 400 kV Kosovë- Shqipëri ka mbajtur 1 (një) mbledhje.
Komisioni për investime kapitale ka mbajtur një(1) mbledhje.
Komisini për shqyrtimin e operimti – ka mbajtur një (1) mbledhje
Komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore – 1 (një) mbledhje

Drejtorët e Bordit në KOSTT në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efiçiencë më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

### 1.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2012 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërje si vijon:

Ramandan Paçarada, (u.d) Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it (Anëtar i Komisionit të Auditimit, Kryetar i Komisionit për projekte kapitale; anëtarë i Komisionit për investime kapitale, anëtar i Komisionit për shqyrtimin e operimit), me profesion: ekonomist
Gjithsejtë kompensimet 2012: 10,345.Euro (Bruto)

Faton Deda, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it dhe anëtar i Komisionit për shqyrtimin e operimit, me profesion: inxhinier
Gjithsejtë kompensimet 2012: 6, 212. Euro (Bruto)

Fatos Ukaj, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it; Kryesues i Komisionit të Auditimit; kryesues i Komisionit për shqyrtimin e operimit; anëtar i Komisionit për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore; me profesion: ekonomist - profesor universitar.
Gjithsejtë kompensimet 2012: 8,782 Euro (Bruto)

Lutfi Maxhuni, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it; kryesues i Komisionit për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore; anëtar i Komisionit për investime kapitale; me profesion: ekonomist
Gjithsejtë kompensimet 2012: 6,472 Euro (Bruto)

Nazmi Mikullovci, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT; kryesues i Komisionit për investime kapitale; anëtarë i Komisionit për shqyrtimin e operimit ; me profesion: inxhinier
Gjithsejtë kompensimet 2012: 8,200 Euro

## 1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual

Gjatë vitit 2012, performanca operative dhe financiare e KOSTT-it është mjaft e mirë dhe tregon përmirësime të vazhdueshme krahasuar me vitin 2011. Zhvillimi i rrjetës transmetuese ka vazhduar. Kapaciteti instalues i transformatorëve në rrjetën 400-220 kV; 400-110 kV ka ngelë në nivelin e njejtë si në vitin paraprak (1800 MVA), kurse kapaciteti i linjave 220-110kV është rritur nga 1200 MVA në 1350 MVA ose 12,5 %. Numri i ankesave për tension ka rënie dhe gjatë vitit 2012 kemi vetëm një ankesë, ndërsa humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë më të vogla për 5.9% në krahasim me vitin 2011. Detajet e perfomancës operative janë dhënë në pjesën 2.3. të këtij Raporti.

Bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues në KOSTT tregon se mbi 25% të rrjedhave fizike të energjjisë nëpër rrjetin transmetues janë tranzit i energjisë për nevoja rajonale, dhe për këtë shërbim, KOSTT edhe më tutje nga mekanizmi i ITC-së nuk është duke marrë të hyra financiare si kompensim për mirëmbajtje dhe humbje, por ky kompensim merret nga EMS ( OST e Serbisë).

Performanca financiare e KOSTT-it më detalisht është paraqitur në Pikën 2.3.5. të këtij Raporti.

Sa i përket planit të vitit 2012, KOSTT ka arritur caqet e parashtruara në objektivat e Planit të Biznesit dhe IKP-të e perfomancës oprative dhe financiare janë pozitive. Këta parametra të performancës së KOSTT-it janë vlerësuar rregullisht nga Bordi i Drejtorëve.

## 1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it

Ngjarjet të cilat kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it paraqesin njëkohësisht edhe risqet me të cilat KOSTT-i ballafaqohet dhe që në mënyrë direkte afektojnë funksionimin e KOSTT-it.

a) Çështja e pazgjidhur e alokimit të kapaciteteve interkonektive me vendet fqinje si pasojë e marrëdhënieve të pazgjidhura me Serbinë.

b) Lidhur me refuzimin e KEK-ut për pranimin e faturave për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2011, ZRrE në bazë të ankesës së KOSTT ka vendosur në favor të KOSTT-it, duke obliguar KEK-un që të paguaj faturat në fjalë. Sidoqoftë KEK ka shfrytëzuar të drejtën ligjore dhe ka ushtruar ankesë ndaj vendimit në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas padisë së KEK kundër vendimit të ZRrE me të cilin obligohet KEK që të paguaj faturat e transmisionit ka hedhur poshtë padinë e

KEK dhe me këtë, KOSTT është një hap më afër në realizimin e pagesave nga KEK për shërbimet e transmisionit.

c) KOSTT nuk është duke e kontrolluar plotësisht operimin e transmisionit në pjesën veriore të Mitrovicës si pasojë e mosdëgjueshmërisë së operatorëve në nënstacionin Vallaq dhe involvimit jolegal të operatorit të sistemit EMS nga Serbia.

d) KOSTT është duke aplikuar në Asociacianet ndërkombëtare të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit (ENTSO-E), me të cilët operojmë në mënyrë sinkrone, gjë e cila na mundëson ndër të tjera edhe pjesëmarrjen në mekanizmat e përbashkëta që valorizojnë çdo transaksion ndërkufitar. Valorizimi i aranzhmaneve ndërkufitare mund ti sjellë të hyra në dobi të KOSTT-it dhe konsumatorëve të Kosovës. Mospranimi i mundshëm i KOSTT në ENTSO–E është një rrezik i mundshëm.

## 1.6. Pasqyrë e të priturave për vitin e ardhshëm

Duke u nisur nga një prej objektivave strategjike të përcaktuara në Planin e Biznesit, që të jetë punëdhënës atraktiv, KOSTT-i do të vazhdojë edhe më tutje punën e suksesshme për krijimin e një ambienti për investimin në zhvillimin profesional të punëtorëve dhe motivimin e tyre në arritjen e performancës së standardeve më të larta. Kjo ndërlidhet edhe me mirëmbajtjen e rrjetit transmetues dhe avancimin e funksioneve të operimit të sistemit të transmisionit e që rezulton në ngritjen e performancës së sistemit të transmisionit. Në të njejtën kohë, KOSTT do të vazhdojë të krijojë kushtet për operimin e tregut në pajtim me zhvillimet e pritura të tregut. Për sa i përket zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike, që lidhet edhe me privatizimin e gjenerimit, Disajni i Tregut i propozuar nga KOSTT, me ndryshimet eventuale që mund të vijnë nga procesi i miratimit nga ZRrE, si dhe Rregullat e Tregut që do shoqërojnë dizajnin e ri, do të jenë bazë e mjaftueshme që do të sigurojnë transparencë të mjaftueshme përdoruesve të rinjë nga proceset e privatizimit. Në përgjithësi se sa, dhe a do të implementohen kërkesat nga dizajni i ri i tregut gjatë periudhës kohore të këtijë plani, do të varet nga pjesëmarrësit në këtë treg dhe kapacitetet e tyre për të ofruar produktet që ky treg i kërkon(balansimi, tregu i çastit etj.)

Gjatë viteve në vijim presim që KOSTT edhe më tutje të sigurojë qëndrueshmërinë financiare dhe të vazhdojë të funksionojë si një organizatë efektive dhe efikase e cila gjithnjë punon në përmirësimin e performancës së punës.

KOSTT-i, bazuar në Planin e Biznesit, pritet të merr pjesë aktive në operimin dhe zhvillimin e tregut rajonal dhe në këtë mënyrë të përfitojë dhe të kontribuojë nga zhvillimi rajonal dhe në mekanizmat ndërkombëtare. Në këtë aspekt vlen të ceket edhe synimi i KOSTT-it që të antarësohet në ENTSO-E dhe të bëhet pjesëmarrës në mekanizmat tjerë ndërkombëtarë.

Detyrë e KOSTT-it mbetet edhe më tutje krijimi i një ambienti të sigurt pune, zhvillimi i marrëdhënieve efektive me palët e interesit dhe sigurimi se KOSTT është dhe do të mbetet një organizatë e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor.

## 1.7. Infomacione lidhur me kapitalin dhe dividendën

Kapitali themeltar i KOSTT-it në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 (*njëzetepesëmijë*) Euro dhe është i ndarë në 2.500 (*dymijepesëqind*) aksione me vlerë nominale 1 (*një*) Euro secili. Kapitali i Shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht në momentin e themelimit të KOSTT-it .

Aksionari i vetëm i KOSTT-it është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas përcaktimit ne Ligjin Nr. 02/L-123, "*Për Shoqëritë Tregtare*", ku përfshihet, shuma, parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksioneve, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themeltar, riblerja ose revokimi i aksioneve, etj.

Struktura e kapitalit është paraqitur në tabelën vijuese:

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**
**PerfundimishtJANAR-DHJETOR/2012**

| | Kapitali aksionar | Kapitali i trasheguar | Fitimi i mbajtur | Total |
|---|---|---|---|---|
| | EUR | | | |
| Kapitali aksionar ne para | (25,000) | | | 25,000 |
| kontributet tjera jo para | | (38,321,922) | | 38,321,922 |
| Fitimi per periudhen e meherhsme | | | | 15,367,648 |
| Fitimi I muajve te mehershem | | | | - |
| Shtesat e share premium | | | | |
| Fitimi per periudhe | | | 2,513,077.71 | 2,513,078 |
| **Bilanci me 31.12.2012** | **(25,000)** | **(38,321,922)** | **2,513,077.71** | **56,227,648** |

Gjatë vitit 2012 nuk kemi hyrë në marrëdhënie të reja kreditore. Nga Marrëveshja për financimin e Linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri, gjatë vitit 2012 është paguar vetem pjesa për provizionin e zotimit në vlerë prej 42,500 euro.

## 1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit

Në KOSTT gjatë vitit 2012 janë bërë investime të shumta bazuar në Planin zhvillimor, që janë përcaktuar në Planin e Biznesit për vitin 2012.

Më poshtë janë përmendur projektet investive, ndërsa statusi i tyre, burimet e financimit të projekteve dhe detajet janë pjesë e këtij Raporti (pika 2.4).

Gjatë vitit 2012 KOSTT ka investuar në projektet e paraqitura në vijim:

1) Shërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400kV dhe 110 kV(vazhdim)
2) Paket Projekti Ferizaj-2,LOT-1: NS 400/110 kV Ferizaj 2(vazhdim)
3) Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-2:LP ndërlidhëse 400kV dhe 110 kV(vazhdim)
4) Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekomi LOT-1 dhe LOT 2(vazhdim)
5) Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1
6) TI për Operimin e Tregut (LOT2) (vazhdim)
7) Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3
8) Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 ( Kosova A - Ferizaj 2)
9) Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3
10) Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)
11) Ndarja e zbarrave në dy seksione, në NS Gjilani 1 dhe NS Therandë
12) Paket Projekti NS 110 /10(20) kV Gjilani 5
13) Rialokimi i linjës 110kV , nr.1806 NS Gjakova 1-Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1
14) Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV, Kosova B
15) Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV në NS Gjilani 1 dhe NS Feriuaji 1
16) Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110 kV në NS Prizreni 2
17) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3
18) Furnizimi me softuerin E-Plan
19) Asfaltimi i rrugës së çasjes për NS 400/110 kV Peja 3
20) Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV Kosova B, dhe instalimi i ndriçimit përgjatë saj, instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në Depo
21) Instalimi i grupeve matëse sipas kufirit të ri KOSTT/KEK (OSSH)

Komisioni i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për Projekte Kapitale, e ka përcjellur statusin e projekteve gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2012.

# 2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

## 2.1. Arritjet kryesore

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit mbetet edhe më tutje një ndër detyrat kryesore të KOSTT. Në këtë drejtim, performanca e operimit të sistemit të transmisionit në vitin 2012 ka pasur ngritje të theksuar. Linjat dhe nënstacionet janë mirëmbajtur sipas planit të paraparë, janë realizuar kontollimet/inspektimet e nënstacioneve dhe linjave, janë realizuar remontet e rregullta vjetore të fushave nëpër NS dhe janë bërë energjizimet e NS-ve, duke përfshirë komisionimin dhe testimin e mbrojtjeve rele, si dhe implementimin e projekteve të rëndësishme[1].

Implementimi i suksesshëm i projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT. Në kuadër të kësaj, vlen të përmendet Paket Projekti Ferizaj 2, LOT 1: NS 400/110 kV Ferizaj 2 dhe LOT 2: Linjat ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS 220/110 kV – Prizreni 2 dhe Instalimi i Autotransformatorit ATR3 150 MVA, Teknologjia Informative (IT) për Operimin e Tregut, etj.

Këto dhe shumë aktivitete tjera kanë ndikuar në ngritjen e performancës së sistemit të transmisionit dhe në vitin 2012 ka pasur ngritje të theksuar.

Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2012, janë paraqitur më detalisht në pikën 2.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2012.

Megjithatë , vlen për t'u përmendur disa nga indikatorët themelor të performancës së sistemit të transmisionit:

- Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit rregullisht kanë qenë më të vogla se ato të planifikuara dhe në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit 2012, janë realizuar 84,64% të humbjeve të parapara në rrjetin e transmisionit dhe 94,10% të humbjeve të realizuara në vitin paraprak (2011). Kjo, padyshim, paraqet një ndër performancat më të rëndësishme të sistemit.

- Numri i ankesave për kualitet të tensionit dhe energjia e pafurnizuar në krahasim me vitin paraprak, janë zvogëluar dukshëm. Kjo tregon se investimet në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimi i sistemit dhe mirëmbajtja preventive, kanë ndikuar në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit gjë që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

[1] Projektet konkrete, energjizimi i të cilave është bërë, si dhe projektet e implementuara, janë dhënë në pikën 2.4. të këtij Raporti, në kuadër të progresit me Planin e Biznesit.

Zhvillimi i infrastrukturës fizike është përcjellë edhe me zhvillimin e infrastrukturës ligjore dhe rregullative. Në bazë të kësaj, KOSTT ka përgatitur Draft Rregullat e Tregut, dokument ky që i është dërguar palëve të rregjistruara për çasje në Rregullat e Tegut, tek ZRrE dhe MZHE. Kjo nënkupton kalimin nga faza ekzistuese e Modelit të Tregut në një fazë më të avancuar që implikon dizajnimin e një tregu të energjisë elektrike të përshtatshëm për investimet në sektorin e energjisë elektrike dhe në harmoni me kërkesat që dalin nga TKE.

Punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimi të të gjitha resurseve të KOSTT, më së miri e dëshmon opinioni i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2011, i cili për të gjashtën herë rradhazi, është pa asnjë kualifikim. Poashtu, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.

Janë aprovuar shumë dokumente të rëndësishme, politika dhe procedura në harmoni me dispozitat e Ligjit të Punës.

KOSTT ka bërë implementimin e sigurimit shëndetësor edhe për 1 vit për të gjithë punëtorët e saj, që është në përputhje të plotë me objektivën e saj strategjike që të jetë një punëdhënës atraktiv, duke dëshmuar edhe një herë se burimet njerëzore janë aseti më i rëndësishëm i KOSTT.

## 2.2. Ngjarjet kryesore të vitit

**1) Vizitat e delegacioneve të Bankës Gjermane për Zhvillim dhe nga Ministria për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim e Republikës Federale të Gjermanisë**
Me 11 janar 2012 anëtari i Bordit të KfW - Dr. Norbert Kloppenburg ka vizituar KOSTT. Vizita është realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet KOSTT dhe KfW, ku është diskutuar për progresin e projekteve në vazhdim si dhe moduleve të bashkëpunimit të ardhshëm.

Në muajin mars 2012, në KOSTT gjithashtu qëndroi edhe një delegacion nga Ministria për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Republikës Federale të Gjermanisë të udhëhequr nga Zyrtarja përgjegjëse për Kosovën.znj. Johanna Brüggeman. Në vizitën e saj njohëse u diskutua rreth bashkëpunimit aktual të KOSTT me Republikën Federale të Gjermanisë përmes Bankes Gjermane për Zhvillim (KfW) si dhe për projektet në vazhdim.Gjatë takimit , znj. Brüggeman u shpreh e kënaqur me punën dhe rezulatet e arritura të KOSTT.

Poashtu, gjatë muajit maj KOSTT-in e ka vizituar një delegacion nga KfW i kryesuar nga Zëvendës Presidenti i Parë për Evropën Juglindore dhe Turqinë, z.Tiskens. Në kuadër të vizitës u diskutua për bashkëpunim aktual dhe progresin e projekteve në vazhdim, si dhe perspektivën e bashkëpunimit të ardhshëm me theks të veçantë në financimin e projekteve zhvillimore. Delegacioni i KfW mbeti i kënaqur me arritjet e KOSTT dhe shprehi vullnetin për vazhdimin e bashkëpunimit.
Edhe gjatë muajit korrik KOSTT-in e ka vizituar një delegacion i KfW. Gjatë takimeve është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në financimin e projekteve të KOSTT, me ç'rast është shprehur mbështetja për KOSTT. Lidhur më këtë KfW ka zhvilluar takime edhe me Ministrinë e Financave me të cilën edhe është nënshkruar një Memorandum i Bashkëpunimit lidhur me projektet e identifikuara.

**2) Ankesa e KOSTT kundër KEK**
Lidhur me ankesën e KOSTT kundër KEK të dorëzuar në ZRrE sipas Rregullit për procedurën për zgjidhjen e kontesteve nga ZRrE, Bordi i ZRrE me vendimin e nxjerrë në shkurt të vitit 2012 ka mbështetur pretendimet e KEK-ut lidhur me mos-pagesën e faturave për shërbimet e transmisionit të cilat tejkalojnë të hyrat e lejuara nga ZRrE. Sidoqoftë, KOSTT nuk është pajtuar me vendimin e ZRrE dhe nëpërmjet padisë kundër ZRrE të dorëzuar në Gjykatën Supreme të Kosovës ka kërkuar nga Gjykata që pjesërisht të anuloj vendimin e ZRrE.
Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas padisë së KEK kundër vendimit të ZRrE me të cilin obligohet KEK që të paguaj faturat e transmisionit ka hedhur poshtë padinë e KEK, dhe me këtë KOSTT është një hap më afër në realizimin e pagesave nga KEK për shërbimet e transmisionit.

**3) Aplikimi për tarifa**
Gjatë muajit janar 2012 KOSTT ka dorëzuar në ZRrE aplikacionin për tarifa për periudhën e Gjashtë të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike.
Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 10 korrik 2012, në

bazë të aplikacionit të KOSTT, ka marrë vendim të aprovojë tarifat dhe ngarkesat e transmisionit, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOSTT sh.a nga data 1 qershor 2012.(V_418_2012).

**4) Transferimi i aseteve 110kV nga KEK ne KOSTT**

Pas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferin e aseteve 110kV në KOSTT, dhe themelimit të Grupit Punues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për koordinimin e aktiviteteve për bartjen e aseteve, palët e përfshira kanë vazhduar punën në identifikimin fizik dhe transferin e aseteve dhe ky proces pas nënshkrimit të Marrëveshjes ka përfunduar, me përjashtim të disa çështjeve administrativo-teknike, do të thotë se që nga 1 prilli KOSTT ka marrë përsipër mirëmbajtjen, planifikimin, zhvillimin dhe operimin e nënstacioneve 110 kV, sipas Vendimit të Qeverisë.

Në bazë të vendimit të Qeverisë gjatë periudhës raportuese është finalizuar transferi i aseteve 110kV nga KEK në KOSTT. Megjithatë, KOSTT në bashkëpunim me KEK duhet ende të punoj në transferin e paluajtshmërive. KOSTT këtu ka hasur në probleme për shkak të mungesës së dokumentacionit të cilat do të mundohemi t'i zgjidhim në baza individuale, rast për rast.

Në të njëjtën kohë KOSTT ka filluar me inspektimin e hollësishëm në terren dhe në bazë të këtij inspektimi do të hartojë prioritetet e investimeve në bazë të urgjencës, në mënyrë që të evitohen problemet eventuale gjatë periudhës së dimrit të ardhshëm.

**5) Privatizimi i KEK Distribucionit dhe Shpërndarjes dhe Projekti Kosova e Re**

KOSTT në cilësinë e vëzhguesit vazhdon angazhimin në Komitetin Drejtues për privatizimin e KEK Distribucionit dhe projektin Kosova e Re. Gjithashtu ka vazhduar angazhimi në komentimin e dokumenteve kyçe të cilat ndërlidhen me KOSTT, siç është draft Marrëveshja për Kyçje, dhe gjithashtu është duke u punuar në hartimin e Rregullave të Tregut edhe pse Modeli i Tregut ende nuk është miratuar nga ZRrE.

**6) Memorandumi për instalimin e OPGW me OST e Malit të Zi**

Gjatë muajit mars KOSTT dhe CGES kanë nënshkruar një Memorandum për instalimin e fibrit optik (OPGW) në përçuesin mbrojtjes të linjes interkonektive Kosovë- Mal i Zi, në pjesën e Malit të Zi. KOSTT i është drejtuar donatorëve me kërkesë për shqyrtimin e mundësisë së instalimit të OPGW dhe në pjesën Kosovare të linjës.

**7)Projekti i linjës 400kV Kosovë – Shqipëri**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 janë paraqitur disa pengesa në kuadër të implemtimit të projektit të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri. Përkatësisht, OST nga Shqipëria ka kontestuar rezultatin e vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues i përbashkët. Lidhur me këtë janë mbajtur një seri takimesh ndërmjet OSTT dhe KfW. Informata më të hollësishme janë paraqitur nga Komisioni i BD për projektin e linjës. Gjatë tërë vitit KOSTT ka vazhduar angazhimin intensiv në përpjekje të zhbllokimit të projektit për ndërtimin e linjës 400kV.

Në tremujorin e fundit të këtij viti, KOSTT dhe OSTT me pëlqimin e ministrive përkatëse të Kosovës dhe Shqipërisë kanë vendosur që të anulojnë tenderin për ndërtimin e linjës 400kV Kosovë-Shqipëri (Lot 1) gjë për të cilën është pajtuar edhe KfW. Lidhur me këtë vendim janë njoftuar edhe ofertuesit të cilët kanë marrë pjesë në tender. Tani pritet që KOSTT dhe OST në bashkëpunim me KfW të përcaktojnë hapat e ardhshëm për vazhdimin sa më të shpejtë të

projektit. KOSTT ka angazhuar një kompani konsulente për të kryer një analizë të tregut dhe arsyeshmerisë për zhvillimin e negociatave me ofertuesin e parë apo përsëritjes të tenderit.

**8) Çështjet e operimit të SEE në pjesën veriore të Kosovës**
Gjatë tremujorit në fjalë KOSTT ka vazhduar të përballet me çështje të ndryshme operative sa i përket operimit të sistemit elektroenergjetik në veri të Kosovës. Këto çështje kryesisht lidhen me ndërhyrjen e operatorit serb EMS në veri, për çka KOSTT ka vepruar në koordinim të plotë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe KEK.

**9) Auditimi i jashtëm i pasqyrave financiare**
Auditori i jashtëm i kontraktuar nga KOSTT për auditimin e pasqyrave financiare dhe rregullative ka dorëzuar Raportin për vitin 2011, i cili sikurse edhe vitet e kaluara, nuk përmban asnjë kualifikim, e që tregon vazhdimësinë e performancës së shkëlqyeshme financiare të KOSTT-it.

**10) Ndërhyrja e operatorit serb në operimin e SEE të Kosovës**
Gjatë periudhës raportuese janë përsëritur ndërhyrjet e operatorit serb EMS në operimin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës duke kyçur njëanshëm linjën interkonektive NS Vallaç – NS Novi Pazar dhe me këtë duke shkelur rregullat për operim të interkoneksionit. Të gjitha institucionet relevante janë njoftuar lidhur me këto zhvillime.

**11) Studimi për Sigurinë e Furnizimit**
Gjatë muajit maj është mbajtur takimi nismëtar i studimit për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në Republikën e Kosovës. Ky studim gjithashtu mbulon edhe mundësinë e operimit të përbashkët të sistemeve elektroenergjetike të Kosovës dhe Shqipërisë.

**12) Dita e Kosovës në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë**
Në kuadër të "Ditës së Kosovës në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë", të mbajtur gjatë qershorit, ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës dhe akterët tjerë nga sektori i energjisë në Kosovë, KOSTT ka prezantuar arritjet gjatë periudhës së kaluar dhe planet për të ardhmen.

**13) Nënshkrimi i Marrëveshje për themelimin e CAO**
Në qershor, përfaqësuesit e dhjetë OST-ve (Kosova, Shqipëria, Kroacia, Bosna dhe Hercegovina, Maqedonia, Greqia, Mali i Zi, Rumania, Sllovenia dhe Turqia) të rajonit nënshkruan Marrëveshjen për Kompaninë e Ekipit të Projektit për themelimin e Zyrës për Alokim të Kordinuar të Kapaciteteve Interkonektive (ang. CAO – Coordianted Auction Office). Selia e Zyres për Alokim të Kordinuar do të jetë në Mal të Zi.
Qëllimi i themelimit të Zyrës për Alokim të Kordinuar të Kapaciteteve të EJL është harmonizimi i metodave të menaxhimit të kongjestionit (fyteve të ngushta) dhe optimizimin e alokimeve të kapaciteteve në kufijtë e zonës tregtuese, si dhe rritja e transparencës në procesin e alokimit të kapaciteteve interkonektive.

**14) Vizita e delegacionit të USEA**
Gjatë qershorit KOSTT-in e ka vizituar një delegacion i USEA (US Energy Association) qëllimi i së cilës ka qenë vlerësimi i gjendjes së përgjithshme në sektorin e energjisë në kontekst me përkrahjen e dhënë nga USAID.

**15) Vendimi i ZRrE për kontestin KOSTT-KEK për refuzimin e pagesës për vitin 2011**
Në muajin korrik ZRrE në bazë të ankesës së KOSTT për refuzimin e pagesës së faturave për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011 ka vendosur në favor të KOSTT, duke obliguar KEK-un që të paguaj faturat në fjalë. Sidoqoftë KEK ka shfrytëzuar të drejtën ligjore dhe ka ushtruar ankesë ndaj vendimit në Gjykatën Supreme të Kosovës.

**16) Zhvillimi i Modelit Financiar**
Në përgatitje për periudhën e ardhshme tarifore pesëvjeçare dhe dorëzimin e aplikimit për tarifa KOSTT ka porositur dhe zhvilluar një model financiar i cili do të shërbej për qëllime të simulimit të afarizmit dhe planeve zhvillimore.

**17) Bashkëpunimi me AUK për zhvillimit e modelit të tregut të përbashkët**
Universiteti Amerikan në Kosovë në bashkëpunim me KOSTT dhe ndërmarrjet simotra nga vendet fqinje, janë duke zhvilluar një model të tregut të përbashkët rajonal, i cili do të shërbej si platformë për zhvillimin e një programi arsimor të dedikuar këtij qëllimi.

**18) Konferenca "Tregu Energjetik Evropa Juglindore 2012"**
Në muajin korrik në Prishtinë është mbajtur konferenca "Tregu Energjetik Evropa Juglindore 2012". KOSTT në këtë Konferencë u paraqit me një prezantim lidhur me sfidat e integrimit të burimeve të ripërtritshme energjetike, kryesisht nga era, në operimin e sistemit.

**19) Pjesëmarrja në dialogun teknik Kosovë-Serbi**
Gjatë vitit 2012KOSTT në mbështetje të delegacionit qeveritar të udhëhequr nga Zëvendës Kryeministrja znj. Edita Tahiri ka marrë pjesë në dialogun teknik Kosovë-Serbi. Në kuadër të dialogut ndër të tjera, është biseduar edhe për çështjet e energjisë, përkatësisht transmisionit. Pritet që dialogu teknik të vazhdojë edhe gjatë periudhës vijuese.

**20) Studimi për kapacitetet telekomunikuese**
Banka Botërore në kuadër të instrumenteve të saj ka miratuar kërkesën e KOSTT për mbështetje me asistencë teknike për studimin e mundësisë për shfrytëzimin komercial të kapaciteteve telekomunikuese të KOSTT. Pritet që studimi të filloj në pjesën e parë të vitit 2013.

**21) Prezantimi i Rregullave të Tregut**
Gjatë muajit korrik KOSTT e ka vizituar një delegacion i KfW. Gjatë takimeve është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në financimin e projekteve të KOSTT, me ç 'rast është shprehur mbështetja për KOSTT. Lidhur më këtë KfW ka zhvilluar takime edhe me Ministrinë e Financave me të cilën edhe është nënshkruar një Memorandum i Bashkëpunimit lidhur me projektet e identifikuara.

**22) Përfundimi i projektit për rehabilitimin e NS 220/110kV Prizreni 2**
Projekti për rehabilitimin e NS 220/110kV Prizreni 2 i financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të IPA është përfunduar me sukses. Ky projekt është i një rëndësie të veçantë pasi që është rehabilitim i nënstacionit ekzistues, dhe projektet e tilla gjithmonë paraqesin sfida në implementim.

**23) Marrëveshja Operative KOSTT-CGES**

KOSTT dhe CGES (OST e Malit të Zi) kanë nënshkruar një marrëveshje operative me të cilën përcaktohet korniza e bashkëpunimit në nivel operativ ndërmjet KOSTT dhe CGES, me të cilën KOSTT plotëson edhe një ndër disa kushtet për anëtarsim me ENTSO-E. Ekzistojnë iniciativa dhe bisedime që marrëveshja për interkoneksion të nënshkruhet edhe me Maqedoninë.

**24)Riçertifikimi me ISO 9001:2008**

KOSTT ka vazhduar të dëshmojë përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta profesionale në menaxhimin e cilësisë, dhe si rezultat i kësaj KOSTT në muajin Shtator përsëri është çertifikuar për herë të tretë me standardin ISO 9001:2008. Duke marrë parasysh këtë, KOSTT është duke e zhvilluar një proces të zhvillimit dhe menaxhimit të cilësisë sipas kërkesave të këtij standardi brenda të gjitha departamenteve dhe zyrave.

**25)Zhvillimi i aplikacioneve të TI**

Krahas zhvillimeve tjera KOSTT gjithashtu ka zhvilluar edhe aplikacione softuerike të cilat do të ndihmojnë stafin në realizimin e kërkesave të ndryshme në formën elektronike çka është arritur një racionalizim dhe lehtësim në implementimin e shumë shërbimeve si: kërkesat e ndryshme të BNJ, prokurimit, finanacve dhe kërkesat tjera të ndërlidhura me punën e departamenteve tjera.

Gjithashtu ka përfunduar zhvillimi i projektit Menaxhimi elektronik i dokumenteve (DMS) dhe Arkiva elektronike, ndërsa implemntimi i tij do të bëhet gjatë vitit 2013.

**26) Balancimi i sitemit të transmisionit**

Me gjithë vërejtjet për mosdiciplinën e KEK-ut në balancimin e kërkesës me furnizim, devijimet ndaj sistemit të regjionit kanë vazhduar të jenë më të mëdha se nga praktika industriale e kujdesshme.

## 2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

### 2.3.1. Balanca e planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2012

| Muajt | Janar-Dhjetor 2012 | | |
|---|---|---|---|
| MWh | E planifikuar | E realizuar | Real/Plan% |
| (1) TC Kosova A | 1 475 280 | 1 948 517 | 132.08 |
| (2) TC Kosova B | 3 392 547 | 3 435 458 | 101.26 |
| (3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B) | 154 763 | 0 | 0.00 |
| (4) HC Ujmani | 82 000 | 64 873 | 79.11 |
| (5) HC Lumbardhi | 27 452 | 22 900 | 83.42 |
| (6)= 1+2+3+4 Prodhimi në prag të transmisionit | 5 104 590 | 5 448 848 | 106.74 |
| (7) Devijimi | 13 761 | - 1 332 | 0.00 |
| (8) Eksporti | 169 392 | 472 794 | 279.11 |
| (9) Importi | 820 840 | 625 058 | 76.15 |
| (10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim | 5 742 277 | 5 602 443 | 97.56 |
| (11) Distribucioni | 4 583 331 | 4 593 410 | 100.22 |
| (12) Ferronikeli | 657 000 | 407 479 | 62.02 |
| (13) Trepça | 31 650 | 23 492 | 74.22 |
| (14) Sharri | 55 935 | 42 881 | 76.66 |
| (15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK | 131 400 | 138 558 | 105.45 |
| (16) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45) | 154 763 | 288 112 | 186.16 |
| (17) = 11+12+13+14+15+16 Kërkesa neto | 5 614 079 | 5 493 931 | 97.86 |
| (18) Humbjet në transmission | 128 198 | 108 512 | 84.64 |
| (19) =17+18 Kërkesa gjithsej | 5 742 277 | 5 602 443 | 97.56 |

Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2012, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.

(3) Energjia për shpenzime vetanake nga (TC A dhe TC B) e cila hyn në rrjetin e transmisionit është e barabartë me energjinë që termocentralet e marrin nga rrjeti i transmisionit për shpenzime vetanake (16). Rreshti (3) në tabelë në vlerat e realizuara është e përfshirë në pikën (6)- Prodhimi në prag të transmisionit.

Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:

**Balanca e planifikuar 2012** | **Balanca e realizuar 2012**



# Diagrami i balancës së realizuar elektroenergjetike Janar- Dhjetor 2012 (GWh)



## 2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit

| Nr | Indikatori | | Janar-Dhjetor 2011 | Janar-Dhjetor 2012 | 2012/2011(%) | Caku | Komenti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **T1** | * Energjia që hyn në transmision (GWh) | | **8443.97** | **8221.91** | **97.37** | Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këte as hyrjet totale në transmision | Caku nuk vendoset për këtë IKP, |
| **T2** | Piku koincident (MW) | | **1150** | **1168** | **101.57** | Caku: 1100MW (Sipas: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2012). | Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që 1,57 % është piku më i lartë në periudhën Janar-Dhjetor 2012 se sa në periudhë të njëjtë 2011. |
| **T3** | Gjatësia totale e linjave (km) | 400 kV | **188.49** | **188.49** | **100.00** | =>1 | Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit. |
| | | 220 kV | **231.882** | **231.882** | **100.00** | | |
| | | 110 kV | **764.94** | **791.3** | **103.45** | | |
| **T4** | MVA-km | 400 kV | **248249** | **248249** | **100.00** | =>1 | Caku është si në T3 |
| | | 220 kV | **77506** | **77506** | **100.00** | | |
| | | 110 kV | **83209** | **88391** | **106.23** | | |
| **T5** | Kapaciteti i transformatorëve | 400-220;400-110 kV | **1800** | **1800** | **100.00** | =>1 | Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri. |
| | | 220-110 kV | **1200** | **1350** | **112.50** | | |
| **T6** | Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar | | | | | | I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Import/Eksport(AATC) | | | | | | anëtare e ENTSO-E |
| T7 | Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC | | | | | | I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E |
| T8 | Pagesa për kongjestion | | | | | | KOSTT do të filloj kur ATC do të alokohet nga Operatori i Transmisionit/kontrollohet nga Operatori i Sistemit për kapacitetet totale të transmisionit (TTC). |
| T9 | Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit) | | 157.82 | 304.00 | 192.62 | Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhen actuale)/(AIT për periudhen e kaluar) < 1 | AIT (Koha mesatare e rënjes)304 minuta gjatë vitit 2012, ndërsa 157.82 minuta për periudhen e njëjtë 2011. |
| T10 | Numri i ankesave për tension | | 2 | 1 | 50.00 | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhen e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë. |
| T11 | Ankesat e zgjidhura për tension | Më pak se një javë | 2 | 1 | 50.00 | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet që në kohë sa më i shkurtër që të jetë e mundur(< 1 javë) të shqyrtohet ankesa. |
| | | Më pak se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraprak(e). |
| | | Më shumë se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T12 | Numri i ankesave për matje | | 0 | 0 | | | |
| T13 | Ankesat e zgjidhura për matje | Më pak se një javë | 0 | 0 | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet që në kohë sa më i shkurtër që të jetë e mundur(< 1 javë) të shqyrtohet ankesa. |
| | | Më pak se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | |
| | | Më shumë se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | |
| T14 | Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë) | Import | 21.38 | 33.94 | 158.77 | 20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar | Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla. |
| | | Eksport | 21.89 | 30.71 | 140.26 | 20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar | |
| T15 | Humbjet në transmision (GWh) | | 115.31 | 108.51 | 94.10 | | Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 5.9 % më të mëdha në periudhën Janar-Dhjetor 2011 se sa në periudhën e njëjtë 2012 |

AIT=(8760*60*ENS)/TE
AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve
ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar
TE-Transmited energy - ET- Energjia e transmetuar

## 2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

| Nr | Indikatori | Niveli i tensionit | 2007-2011 | 2012 | Krahasimi | Caku | Komenti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kV | Indikatorët mesatar të performancës | Janar-Dhjetor | 2012/ Mesatarja (%) | | |
| T1 | Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi | 400 | 0.55 | 0.00 | 0.00 | ≤ 1 | |
| | | 220 | 1.38 | 1.30 | 0.94 | | |
| | | 110 | 2.74 | 1.40 | 0.51 | | |
| T2 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë) | 400 | 1.01 | 0.00 | 0.00 | > 1 | Këputja e përçuesit në LP 118/1 |
| | | 220 | 2.90 | 3.11 | 1.07 | | |
| | | 110 | 6.52 | 13.23 | 2.03 | | |
| T3 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta) | 400 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | ≤ 1 | |
| | | 220 | 2.00 | 0.00 | 0.00 | | |
| | | 110 | 0.19 | 0.00 | 0.00 | | |
| T4 | Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi) | 400/220(110) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | ≤ 1 | |
| | | 220/110 | 14.24 | 0.00 | 0.00 | | |
| T5 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë) | 400/220(110) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | ≤ 1 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T6 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta) | 400/220(110) | 0.32 | 0.00 | 0.00 | ≤ 1 | |
| | | 220/110 | 0.20 | 0.00 | 0.00 | | |
| T7 | Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha | 400 | 12.00 | 0.01 | 0.00 | ≤ 1 | |
| | | 220 | 12.33 | 0.00 | 0.00 | | |
| | | 110 | 14.19 | 1.57 | 0.11 | | |
| T8 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë) | 400 | 4.00 | 4.25 | 1.06 | > 1 | Natyra e prishjes ka qenë e tillë që është nevojitur kohë për eliminim, megjithatë është evituar në kohë rekorde, bazuar në natyrën e prishjes. |
| | | 220 | 5.33 | 1.00 | 0.19 | | |
| | | 110 | 7.79 | 4.41 | 0.57 | | |
| T9 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta) | 400 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | ≤ 1 | |
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | |
| | | 110 | 1.36 | 0.00 | 0.00 | | |
| T10 | Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha | 400 | 8.00 | 10.00 | 1.25 | > 1 | Është djegur një modul i rrymave nga TMR të mbrojtjes mbirrymore në fushën lidhëse 400 kV në NS Ferizaji 2 |
| | | 220 | 6.51 | 0.00 | 0.00 | | |
| | | 110 | 3.23 | 0.00 | 0.00 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T11 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë) | 400 | 2.70 | 0.25 | 0.09 | ≤ 1 | |
| | | 220 | 4.52 | 0.00 | 0.00 | | |
| | | 110 | 3.26 | 0.00 | 0.00 | | |
| T12 | Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta | 400 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | ≤ 1 | |

## 2.3.4. Operimi i tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral dhe i rregulluar ku mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Për shkak të mungesës së konkurrencës dhe furnizuesve të tjerë të pavarur dhe në bazë të ligjeve të reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Është arritur marrëveshje midis KEK , Feronikelit dhe ZRrE që Feronikeli të furnizohet nga KEK me çmim të rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet si raport i energjisë së konsumuar në nivelin 220kV në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë e shprehur në diagramet më poshtë.

Në krahasim me vitin 2011, në këtë vit kemi një zvogëlim të humbjeve nga 115.315 MWh në 108.511 MWh, që shprehur në përqindje, zvogëlimi është 5.90% krahasuar me vitin e kaluar .

Tranziti i energjisë elektike në këtë vit në Rrjetin e KOSTT ka qenë 2.124.573MWh gjegjësisht 25% të rrjedhave fizike të energjjisë nëpër rrjetin transmetues. Edhe më tuje KOSTT nuk kompensohet për këtë shërbim nga mekanizmi i ITC por kompensohet EMS ( TSO e Serbisë).

Sipas vlerësimeve të KOSTT, energjia elektrike e reduktuar në këtë vit është mesatarisht rreth 2.54% e konsumit vendor, nga 5.46% sa ishte në periudhën e njëjtë në 2011.

Konsumi tarifor në nivelin me pakicë në këtë vit e furnizuar nga rrjeti 110kV ka qenë 4.682.684MWh apo 85.65%. e konsumit total ta dal nga rrjeti transmetues që ishte 5.516.832MWh.

# Tregu i rregulluar dhe i pa-rregulluar




Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues




Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision

## 2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet

Në vazhdim, janë paraqitur Draft Pasqyrat Financiare (të pa audituara)

## Draft Bilanci i Gjendjes

| 01/01/2012-31/12/2012 | | | |
|---|---|---|---|
| **ASETET** | Note | 2012<br>000 EUR | **2011<br>000 EUR** |
| **Asetet afatgjata** | | 114,693.00 | **95,559.00** |
| Prona dhe pajisjet | 4 | 112,538.00 | 94,102.00 |
| Asetet e paprekshme | 5 | 2,155.00 | 1,457.00 |
| **Asetet afatshkurtëra** | | 32,187.00 | **31,040.00** |
| Stoqet | 6 | 1,838.00 | 1,654.00 |
| Të arkëtueshmet | 7 | 11,554.00 | 7,590.00 |
| Kerkesat tjera | | 733.00 | 3,191.00 |
| Paraja në dorë dhe në bankë | 8 | 18,062.00 | 18,605.00 |
| **TOTAL ASETET** | | 146,880.00 | **126,599.00** |
| **EKUITETI DHE OBLIGIMET** | | 56,504.00 | **43,740.00** |
| Kapitali i pronarëve | 10 | 25.00 | 25.00 |
| Primi i aksioneve | 11 | 38,322.00 | 28,347.00 |
| Fitimet e mbajtura | | 15,368.00 | 14,085.00 |
| Fitimi i vitit | | 2,789.00 | 1,283.00 |
| **Obligimet** | | 81,709.00 | **75,414.00** |
| Grantet e shtyera | 12 | 81,709.00 | 75,414.00 |
| **Obligimet afatshkurtera** | | | |
| **DETYRIMET KURENTE** | | **8,667.00** | **7,445.00** |
| Pagueshmerite dhe obligimet tjera | 13 | 8,667.00 | 7,308.00 |
| Detyrimi I tatimit te periudhes | | | 137.00 |
| Detyrimi I tatimit te shtyer | 14 | | |
| | | 90,376.00 | 82,859.00 |
| | | 146,880.00 | **126,599.00** |

## DRAFT PASQYRA E FITMIT DHE HUMBJES

**01/01/2012-31/12/2012**

| | Note | 2012 | 2011 |
|---|---|---|---|
| | | 000 EUR | 000 EUR |
| **Te hyrat operative** | | *20,907.00* | *18,249.00* |
| Te hyrat nga Tarifat e perkohshme | 15 | 15,636.00 | 14,706.00 |
| Te hyrat tjera operative | 16 | 5,271.00 | 3,543.00 |
| **Shpenzimet operative** | | 17,785.00 | 16,820.00 |
| Shpenzimet e stafit (pagat) | 17 | 3,950.00 | 2,945.00 |
| Kompenzimet tjera | | 81.00 | 127.00 |
| Materilai hargjues | | 45.00 | 47.00 |
| Amortizimi | 4 | 8,769.00 | 6,349.00 |
| Shpenzimi i energjise,telefonit dhe ujit | | 389.00 | 245.00 |
| Riparime dhe mirembajtje | 18 | 667.00 | 744.00 |
| Shpenzimi i derivateve dhe lubrifikanteve | | 109.00 | 88.00 |
| Shp.e sherb. Medicina.Sigurimi.Trans. | 20 | 130.00 | 194.00 |
| Humbjet e energjise | 21 | 3,433.00 | 3,579.00 |
| Provizioni I kerkesave kontestuese | 22 | | 2,390.00 |
| Shpenzimet tjera operative | 19 | 212.00 | 112.00 |
| Rregullimi sekundar | | - | |
| Fitimi para tatimit | | 3,122.00 | 1,429.00 |
| Tatimi | | 333.00 | 194.00 |
| Te hyrat/shpenz nga tatimi I shtyer | | | (48.00) |
| **Neto fitimi per periudhe** | | 2,789.00 | 1,283.00 |

DRAFT.

**PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE**

**01/01/2012-31/12/2012**

| | 2012 | 2011 |
|---|---|---|
| | **000 EUR** | **000 EUR** |
| ***RRJEDHA E PARASE NGA AKTIVITETET OPERATIVE*** | | |
| Fitimi gjate vitit paraq tatimit | 3,122.00 | 1,429.00 |
| Shpenzimet e taksave | | |
| Provizionimi I stoqeve | 106.00 | 23.00 |
| Provizionimi I kerkesave | | 2,390.00 |
| Te hyrat nga interesi | (617.00) | (543.00) |
| Shlyerja e mjeteve themelore. | 88.00 | 2.00 |
| Amortizimi I palujtshmerive,impianteve dhe pajisjeve | 8,769.00 | 6,349.00 |
| Te hyrat e shtyera | (5,262.00) | (3,276.00) |
| | 560.00 | 194.00 |
| Rrjedha operative e parase para levizjeve ne kapitalin punues | **6,766.00** | **6,568.00** |
| Rritje e Stoqeve nga Grantet | | |
| Rritje-zvoglimi ne stoqe,pjese rezerve dhe vegla-inventari | (290.00) | (560.00) |
| Rrritje-zvoglimi ne Arketueshmeri dhe kerkesa tjera | (3,964.00) | (973.00) |
| Rritje -zvoglimi ne parapgime dhe depozites ndaj furnitorve | 2,458.00 | 3,805.00 |
| Rritje-zvoglimi ne pagueshmeri dhe obligime tjera | 1,222.00 | (1,649.00) |
| Detyrimi I tatimit te periudhes. | | |
| Detyrimi per tatimin e shtyer. | | |
| Gjenerimi i parase nga aktivitetet operative | **6,192.00** | **7,191.00** |
| Pagesa e tatimit ne te hyra | (495.00) | (194.00) |
| **Paraja neto nga aktivitetet operative** | **5,697.00** | **6,997.00** |
| ***RRJEDHA E PARASE NGA AKTIVITETET INVESTIVE*** | | |
| **Te hyrat nga donacionet** | 11.557.00 | 9.298.00 |
| **Pagesa e donacioneve-Kthimi I Mieteve ne Buxhetin e Kosoves.** | | |
| Intersi i pranuar | 617.00 | 543.00 |
| Blerja e aseteve te reja | (18,414.00) | (13,083.00) |
| **Paraja neto nga aktivitetet investive** | **(6,240.00)** | **(3,242.00)** |
| Rritja neto e parase dhe ekuivalenteve te parase | **(543.00)** | **3,755.00** |
| **Paraja dhe ekuivalentet e parase me 31.12.2011** | **18,605.00** | **14,850.00** |
| **Paraja dhe ekuivalentet e parase me 31.12.2012** | **18,062.00** | **18,605.00** |

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**
**Përfundimisht JANAR-DHJETOR/2012**

| | Kapitali aksionar | Kapitali i trashëguar | Fitimi i mbajtur | Total |
|---|---|---|---|---|
| | ---------- 000 EUR ---------- | | | |
| Kapitali aksionar në para | 25 | | | 25 |
| kontributet tjera jo para | | 38,322 | | 38,322 |
| Fitimi për periudhën e mëhershme | | | | 15,368 |
| Fitimi i muajve te mëhershem | | | | - |
| Shtesat e share premium | | | | |
| Fitimi për periudhen e mëhershme | | | 2,789.00 | 2,789 |
| **Bilanci me 31.12.2012** | **25** | **38,322** | **2,789.00** | **56,504** |

## Informacionet për vitin financiar 2012

Të hyrat operative gjatë vitit 2012 kanë qenë 20,907 mijë euro dhe janë për 14.6% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet operative janë realizuar në vlerën prej 17,785 mijë euro dhe janë për 5.7 % më të larta në krahasim me vitin e kaluar, për shkak të transferit të aseteve nga KEK në KOSTT.

Të hyrat e realizuara nga tarifa janë në vlerë prej 15,636 mijë euro dhe janë për 6.3% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa të hyrat tjera operative në vlerë prej 5,271 mijë euro janë për 48.8% më të larta se në vitin 2011.

Fitimi para tatimit për vitin 2012 është në vlerë 2,789 mijë euro.

Asetet joqarkulluese janë në vlerën prej 114,693 mijë euro, pasuritë qarkulluese 32,187 mijë euro dhe gjithësejt pasuria e KOSTT sh.a. në vitin 2012 është në vlerën 146,880 mijë euro.

Kapitali akcionar dhe rezervat janë në vlerën 56,504 mijë euro, detyrimet afatgjata (të hyrat e shtyera) 81,709 mijë euro dhe detyrimet afatshkurtëra 8,667 mijë euro.

Nga të dhënat e prezantuara, shihet se pasuria e KOSTT-it është financuar:

- 38,67% kapitali i akcionarit
- 55,67 % grante qeveritare dhe grante tjera
- 5,66 % detyrime afatshkurtëra

Struktura e kapitalit nuk ka ndryshuar dhe është e rritur vetëm për vlerën e fitimeve të mbajtura.

**Aplikimi për të hyra maksimale për periudhën 2013 – 2017**

Gjatë vitit 2012 KOSTT ka zhvilluar edhe një aktivitet shum të rëndësishëm lidhur me aplikimim për të hyra pesëvjeçare në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë.Të hyrat maksimale të miratuara nga ZRrE paraqesin bazën për përcaktimin e tarifave dhe të hyrave sipas viteve që pasojnë. KOSTT për këtë qëllim, duke filluar që nga tremujori i parë të vitit 2012, ka punuar në definimin e një Modeli të Ri financiar që do të reflektoj realitetet e reja biznisore, planin zhvillimor dhe si konsekuencë, planin afatmesëm investiv duke testuar edhe burimet reale të financimit dhe testimin në ndikimin në tarifat e transmisionit që minimizojnë riskun rregullator.

Paralelisht KOSTT ka punuar dhe negociuar me ZRrE edhe në miratimin e rregullimeve të reja që i referohen të hyrave për periudhën e ardhshme pesëvjeçare. Rregullimet në fjalë, si dhe baza e imputeve biznisore të zhvilluara, mund të konsiderohen si një performancë e mirë për të vërë nën kontroll afarizmin me risqe të zvogëluara në pesëvjeçarin që pason.

## 2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare

Në vazhdim, janë dhënë IKP-të që paraqesin performancën financiare të KOSTT-it gjatë vitit 2012.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **T1. Fitimi operativ margjinal** = Fitimi neto /gjithësejt të hyrat | **0.07** | **0.15** | Qëllimi është që të jetë mbi zero.<br>Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese.<br>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj.<br>Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë. |
| **T2. Treguesi i qarkullimit** = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese | 4.17 | **3.93** | Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtëra, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtëra. Optimalja e këtij treguesi është **1.5**. |
| **T3. Mbulimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes** = të hyrat e rregull./ shp. e mirëmbajtjes | **25.29** | **33.19** | Në rastin kur do të realizohej e tërë mirëmbajtja e planifikuar, ky tregues do të kishte vlerën 9.53, që do të ishte rasti ideal ( 15,640,035/1,639,740) |
| **T4. Mbulimi i të hyrave** = gjiths.të hyrat/ shpenzimet e lejuara | **1.24** | **1.19** | Treguesi duhet të jetë **më i madh=1** |
| **T5. Mbulimi shpenz .të lejuara** = shpenzimet e lejuara/gjithësejt të hyrat | **0.81** | **0.84** | Treguesi duhet të jetë **më i vogël se 1 ose =1** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **T6.Gjith.të hyrat ndaj të hyr.të lej =** gjiths.të hyrat e rregulluara/të hyrat e lejuara | 1.10 | 1.14 | Këtu vihen në raport vetëm të hyrat e rregulluara të realizuara dhe të hyrat e lejuara.Treguesi duhet të jetë **=1.** Për shak të rrjedhave më të mëdha të energjisë, treguesi është më i madh se 1. |
| **T7. Qarkullimi i arkëtueshmërisë =** gjithësejt të hyrat/ mesatarja e llog. të arkët. | 2.23 | 2.25 | Duhet të jetë **4.1** në mënyrë që të realizohet objektivi ( i paraqitur në treguesin më poshtë), që periudha mesatare e arkëtimit të jetë 90 ditë. (365 ditë/4.1) |
| **T8. Periudha mesatare e arkëtimit =** 365 ditë/qarkullimi i arkëtueshmërisë | 164 ditë | 153 ditë | 90 ditë |
| **T9. Shpenzimet e lejuara për km. të rrjetit** | 12.65 €/km | 15.15 €/km | Kosto e shpenz.të lejuara për km të rrjetit është më e larte krahasuar me vitin paraprak. |
| **T10. Shpenzimet e lejuara për GWh e transmetuara** | 1.79 | 2.21 | Ky indikator ndërlidhet me metodologjinë e tarifave të ZRrE-së, e cila për periudhën raportuese ka lejuar shpenzimet totale për njësi 2.30 m €/GWh.<br>Ky indikator tutje analizohet duke iu referuar treguesit **T12,** që paraqet shpenzimet totale (të realizuara) për njësi, ku shihet se KOSTT ka transmetuar energji me shpenzimet reale 2.23 m €/GWh. |
| **T11. Të hyrat e lejuara për GWh e transmetuara** | 2.03 | 2.30 | Paraqet të hyrat për njësi.<br>Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike |
| **T12. Shpenzimet totale për njësi** = shpenzimet totale/GWh e transmetuara | 2.06 | 2.23 | Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike. |
| **T13. Detyrimet ndaj aseteve** = dety. aftshk+det.afatgjat /gjiths.asetet | 0.059 | 0.056 | Qëllimi është që të jetë **më i vogël se 1.** |
| **T14. Kthimi në asete neto (RONA)=** fitimi neto/asetet neto | 0.01 | 0.02 | Objektivi: të jetë **më i madh se mesatarja e industrisë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| T15. **Treguesi i ekuitetit** = gjiths.të hyrat/ kapitali | **0.16** | **0.16** | Objektivi: **më i madh se 0** |
| T16. **Asetet neto** = gjiths.asetet-detyrimet | **119,153** | **138,583** | Objektivi: **Asetet>Detyrimet** |

**Vërejtje:** Indikatorët T4 dhe T12, kanë të bëjnë me të hyrat dhe shpenzimet e lejuara bazuar në metodologjinë e tarifave. Për t'u caktuar caku real, duhet të mblidhen të dhënat mbi kostot historike.

## 2.4. Progresi me Planin e Biznesit

Për të analizuar progresin e KOSTT me Planin e Biznesit, së pari do të theksohen: roli, vizioni dhe misioni.

Roli i KOSTT-it është që të operojë sistemin e transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike në Kosovë, me një mision të qartë që të sigurojë shërbime kualitative duke implementuar të arriturat teknike-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit, transparencë dhe jo-diskriminim për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit në tregun konkurrues të energjisë elektrike dhe avansim të pozitës së kompanisë në nivel ndërkombëtar përmes aktiviteteve të shtuara në këtë drejtim.

Në përputhje të plotë me vizionin e vet, KOSTT synon që "Të ofrojë shërbime të sigurta dhe të besueshme për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit, e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor, e integruar në mekanizmat evropianë të transmisionit të energjisë elektrike, duke qenë njëkohësisht edhe fitimprurëse".

Për të realizuar synimet e përcaktuara dhe duke u nisur nga misioni i KOSTT, janë vendosur edhe objektivat, pjesa dërmuese e të cilave janë objektiva strategjike dhe të cilat do të hasen edhe në planet e biznesit edhe për disa vite me rradhë.

Objektivat e vendosura të KOSTT për vitin 2012 janë:

- Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit transmetues të energjisë elektrike;
- Avansimi i mirëmbajtjes së sistemit të transmisionit;
- Siguria dhe besueshmeria e sistemit të transmisionit;
- Krijimi i kushteve për operimin e tregut të energjisë elektrike në pajtim me zhvillimet e pritura;
- Qëndrueshmëria financiare;
- Pjesëmarrje aktive në proceset e zhvillimit të tregut rajonal (të përfitojë/kontribuojë nga zhvillimi rajonal);
- Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombetarë;
- Vendosja e marrëdhënieve efektive me palët e interesit;
- KOSTT të jetë punëdhënës atraktiv, ambient për investimin në zhvillimin profesional të punonjësve;
- KOSTT të jetë kompani e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor;
- Krijimi i një ambienti të sigurt pune

Duke u nisur nga objektivat e lartcekura, do të analizohen të arriturat e KOSTT gjatë vitit 2012, respektivisht, implementimi i këtij Plani.

Edhe këtë vit, performanca e operimit të sistemit të transmisionit ka pasur ngritje të theksuar. Nuk ka pasur prishje të transformatorëve, është zvogluar numri i prishjeve në

linja dhe nuk ka pasur prishje me ndikim ne sistemin e kontrollit, monitorimit, telekomunikimit, mbrojtjes në rrjetin transmetues. [2]

Gjatë vitit 2012, janë realizuar 93 % të aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i autotransformatorëve dhe transformatorëve, kontrollimi me termovision i nënstacioneve dhe linjave, shqyrtimi i rregullt i fushave , shqyrtimet e shpenzimeve vetjake dhe të mbrojtjeve rele të transformatorëve të fuqisë, remonti i fushave dhe linjave, etj.
Përveç kësaj, janë ndërmarrur një mori aktivitetesh që kanë ndikuar në ngritjen e performancës, si: montimi i reaktancave të reja në NS Gjilani 1, NS Prizreni 1dhe NS Ferizaj 1, ndërrimi i ndërprerësit të fuqisë në fushën e linjës LP445/1, verifikimi dhe kontrollimi i gjendjes se stabilimenteve të cilat kanë kaluar nga KEK në KOSTT, etj.

Janë bërë avansime në ngritjen e funksioneve operative të planifikimit dhe veçmas në operimin e sistemit në kohën reale, ku duke filluar nga viti 2011 është mundësuar monitorimi dhe kontrolli në kohën reale i një pjese të konsiderueshme të rrjetit transmetues të Kosovës. Pjesa e pa përfshirë në këto mundësi është pjesa veriore ku për shkaqe të njohura ende nuk është mundësuar përfshirja në kët paket e NS Vallaq dhe HC Ujmani, pastaj 4 nënstacionet e reja dhe disa transformator të shtuar në ato egzistuese, të implementuara pas përfundimit të projektit të SCADA\EMS&Telekomit. Megjithate, pas kalimit te aseteve 110/x kV së bashku me shërbimet përcjellëse nga KEK në KOSTT , për operim dhe kontroll të sistemit duhet të zgjerohet niveli i kontrollit dhe monitorimit deri në kufirin e ri dhe kjo do të funksionalizohet në kontinuitet dhe po ashtu do të përfshihen edhe ndryshimet e tjera në rrjetin transmetues për shkak të zhvillimeve të rrjetit.
Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avansuara për operim të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe në kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektroenergjetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative të Bllokut Rregullues. Që nga shtatori 2012 është duke u shfrytëzuar platforma për parashikim të konsumit nacional "Load Forecast", e cila po gjeneron rezultate relativisht të mira, duke patur parasysh mospërfshirjen e tërësishme të rrjetit transmetues të Kosovës në SCADA\EMS.
Infrastruktura e matjeve komerciale ka përmirësuar në masë të konsiderueshme leximin e të dhënave kumulative të energjisë elektrike në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues përmes përdorimit të lidhjeve optike, në pronësi të KOSTT-it.

Gjatë viti 2012 është bërë edhe një studim i përbashkët i një konsulence me stafin e telekomit për mundësitë e komercializimit të fijeve optike tepricë të KOSTT-it.

Nga aspekti i sistemeve SCADA/RTU janë bërë një varg ndërhyrjesh në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemeve të SCADA-ve ekzistuese si ndërrimin e HMI-ve, monitorëve, BCU-ve, përfshirjen e të dhënave të reja në SCADA lokale në pajtim me llojet e pajisjeve primare të zëvendësuara. Është bërë edhe testimi periodik i funksionalitetit të qendrës emërgjente dispeçerike i cili ka rezultuar me sukses.

---

[2] Shih Tabelën e Inikatorëve Kyç të Performancës së operimit të transmisionit në pikën 2.3.3 të këtij Raporti

Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, të cilat janë dhënë në vijim:

- Funksionalizimi dhe vurja në operim të plotë i Qendrës Dispeqerike Nacionale Emergjente (rezervë)
- Krijimi i kushteve të interkonektimit me fibër optik me TSO-on e Maqedonisë për komunikime inter-TSO
- Funksionalizimi i plotë i qendrës për menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të infrastrukturës telekomunikuese – NMS (Network Management System), kryesore në KCS dhe rezervë në EKCS, si dhe i radio sistemit telekomunikues
- instalimi i 20 RTU-SCADA sistemeve në nënstacione 110 kV/X kV, të cilat së bashku me sistemet ekzistuese të SCADA e furnizojnë me të dhëna sistemin SCADA/EMS
- lëshimi në punë i sistemit SCADA në NS Ferizaj 2 400 kV/110 kV, prodhim i SIEMENS, NS Palaj dhe NS Skënderaj
- Montimi i modemave me adaptera për komunikim permes rrjetit fiber optik.
- me ndihmën e interfejseve (ndërlidhjeve) TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, është mundësuar integrimi HVM në rrjetet lokale të KOSTT, duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (GSM) dhe njëkohesisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre
- me ndihmën e interfejseve TCP/IP, rrjeteve ethernet dhe centralit telefonik IP, është mundësuar gjithashtu integrimi i gadi të gjitha objekteve elektroenergjetike në rrjetin lokal telefonik të KOSTT – VOIP (Voice over IP), duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashteme publike (PTK) dhe njekohësisht duke zvogluar koston e shfrytëzimit të tyre
- testimi periodik i sistemeve matëse dhe matja e gabimit të tyre
- përshtatja e sistemeve matëse me Kodin e Matjeve
- mirëmbajtja dhe kontrollimi i njehsorëve dhe i pajisjeve për grumbullimin dhe dërgimin e të dhënave në Qendër Grumbulluese (RMC)
- administrimi dhe Operimi me RMC (Remote Metering Center), kalkulimi dhe analiza e humbjeve të energjisë elektrike në transmision.

KOSTT gjatë vitit 2012 ka bërë investime kapitale të shumta bazuar në Planin Zhvillimor të Transmisionit, që janë përcaktuar në Planin e Biznesit për vitin 2012 dhe që janë të paraqitura në vijim:

1) Shërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, financuar nga EUOK (ECLO) në kuadër të Programit IPA 2008;

- *Statusi i projektit: i kompletuar*

2) Paket Projekti Ferizaj 2, LOT 1: NS 400/110 kV Ferizaj 2, financuar nga Buxheti i Kosovës;

- *Statusi i projektit: i kompletuar; kontraktuesit i është lëshuar Çertifikata e Pranimit Final (FAC – Final Acceptance Certificate)*

3) Paket Projekti Ferizaj 2 LOT 2: Linjat ndërlidhëse 400 dhe 110 kV, financuar nga EUOK (ECLO) në kuadër të programit 2008;

- *Statusi i projektit: i kompletuar; kontraktuesit pritet t'i lëshohet Çertifikata e Pranimit Final (FAC – Final Acceptance Certificate) në Shkurt 2013, sipas kushteve të kontratës*

4) Paket Projekti SCADA/EMS (LOT1) dhe Telekomi (LOT2), financuar nga Buxheti i Kosovës;

- *Statusi i projektit: në fazën parafinale të kompletimit*

5) Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS 220/110 kV - Prizreni 2 dhe Instalimi i Autotransformatorit ATR3 150 MVA (LOT1) dhe Teknologjia Informative (TI) për Operimin e Tregut (LOT2);

6) *Statusi i projektit: i kompletuar;*

7) Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS 220/110 kV – Prizreni 2 dhe Instalimi i Autotransformatorit ATR3 150 MVA (LOT1), financuar nga EUOK (ECLO) në kuadër të programit IPA 2009;

- *Statusi i projektit: i kompletuar; kontraktuesit i është lëshuar Çertifikata e Pranimit të Përkohshëm (PAC – Provisional Acceptance Certificate) dhe është në periudhën garantuese*

8) Teknologjia Informative (TI) për Operimin e Tregut (LOT2), financuar nga EUOK (ECLO) në kuadër të programit IPA 2009;

- *Statusi i projektit: i kompletuar; kontraktuesit i është lëshuar Çertifikata e Pranimit të Përkohshëm (PAC – Provisional Acceptance Certificate) dhe në Shkurt 2013 do t'i lëshohet Çertifikata e Pranimit Final (FAC - Final Acceptance Certificate)*

9) Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: është në fazën e implementimit dhe ka vonesa në kompletim, si pasojë e mospërformnacës së duhur të kontraktuesit në përgaditjen e dokumentacionit fillestar dhe për më tepër problemeve në zgjidhjen e çështjeve pronoësore – juridike me pronarët e tokave, ku do të ndërtohen shtyllat e reja*

10) Kyçja e NS 110/10 kV – Lipjani në linjën LP 212 (drejtimi NS Kosova A – NS Ferizaj 2), financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: është në fazën e implementimit dhe ka vonesa në kompletim, si pasojë e problemeve në zgjidhjen e çështjeve pronoësore – juridike me pronarët e tokave, ku do të ndërtohen shtyllat e reja*

11) Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/10 kV – Prishtina 2 dhe NS 110/35 kV – Prishtina 3, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: i kompletuar, sipas kushteve të kontratës*

12) Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese), financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: i kompletuar dhe është në periudhën garantuese deri më 13.09.2013.*

13) Ndarja e zbarrave në dy seksione, në NS Gjilani 1 dhe NS Therandë, financuar nga buxheti KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: i kompletuar dhe është në periudhën garantuese deri më 12.12.2013.*

14) Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806, drejtimi NS Gjakova 1 – NS Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: ka vonesa në implementim, si pasojë e mospërformnacës së duhur të kontraktuesit në sigurimin e dokumentacionit fillestar dhe procedurave të sigurimit të Lejës Ndërtimore*

15) Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV – Kosova B, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: i kompletuar dhe është në periudhën garantuese deri më 09.11.2013*

16) Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: është në fazën e implementimit dhe ka vonesa në implementim, si pasojë e zhvillimeve në sigurimin e Lejes Ndërtimore (periudha kalimtare: miratimi i Ligjit të ri të Ndërtimit), performancës jo edhe aq të mirë të kontraktuesit në zbatimin e projektit, dhe mos sigurimit të kushteve për punë për kontraktuesin: shkyçjet në nënstacion*

17) Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110 kV në NS Prizreni 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: ka vonesa në implementim, si pasojë e mospërformnacës së duhur të kontraktuesit*

18) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: në fazën e tenderimit*

19) Furnizimi me softuerin E-Plan, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: i kompletuar dhe është në periudhën garantuese deri më 23.11.2013*

20) Asfaltimi i rrugës së qasjes për NS 400/110 kV – Peja 3, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: i kompletuar dhe është në periudhën garantuese deri më 15.11.2013*

21) Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV Kosova B, dhe instalimi i ndriçimit përgjatë saj, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: në fazën e tenderimit*

22) Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në Depo, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: në fazën e tenderimit*

23) Instalimi i grupeve matëse sipas kufirit të ri KOSTT/KEK (OSSH), financuar nga buxheti i KOSTT-it

- *Statusi i projektit: në fazën e tenderimit*

Siç mund të shihet nga përshkrimi i mësipërm, shumica e këtyre projekteve janë kompletuar ose janë futur në operim/përdorim dhe janë në fazën garantuese, kurse në anën tjetër edhe Komisioni i Bordit për Investime Kapitale e ka përcjellë statusin e projekteve, gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2012, me ç 'rast për të gjitha problemet dhe vonesat është njoftuar më kohë dhe ka dhënë rekomandime për Bordin e Drejtorëve se si të veprohet më tutje, për rastet e vonesave në projekte.
Ndërrimi i regjimit të zgjidhjes së çështjeve pronësoro-juridike dhe si pasojë e mospërfshirjes së kohës përkatëse për zgjidhjen e tyre në dokumentacionin tenderues, ka shkaktuar vonesa në implementim të një numri të vogël të projekteve.

Të gjitha këto investime të lartcekura në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit dhe mirëmbajtjen preventive, kanë ndikuar në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit gjë që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

KOSTT gjatë vitit 2012 gjithashtu ka përmirësuar edhe bazën e shkathtësive dhe ekspertizës për të shërbyer në mënyrë efikase edhe kyçjen e gjeneratorëve të rinjë dhe posaçërisht atyre të burimeve të ripërtëritshme, ashtu që gjatë viteve pasuese do të firmos një numër të konsiderueshëm të Marrëveshjeve për Kyçje që do të kenë një ndikim të konsiderueshëm në afarizmin e tij.

Kryerja e obligimeve me kohë ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës, dëshmon më së miri për arritjen e synimit të KOSTT që të jetë një kompani financiarisht e qëndrueshme.

Njëra nga objektivat strategjike të definuara në Planin e Biznesit të KOSTT, është përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj. Për këtë qëllim, KOSTT ka vazhduar edhe në vitin 2012 me projektin e sigurimit shëndetësor për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë. Sigurimi shëndetësor do të ndikojë në motivimin e punëtorëve për punë dhe me këtë, KOSTT do ta përmbush objektivën strategjike, për të qenë punëdhënës atraktiv.

Në harmoni me objektivin e përgjegjshmërisë nga aspekti social, KOSTT ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë për punëtorët e saj, duke i siguruar kushtet e mira të punës në bazë të standardeve më të larta, siç janë renovimet e ndërtesës, masat e ndërmarra për parandalimin e rreziqeve në punë dhe paisjet mbrojtëse në punë.

Përgjegjësinë e saj nga aspekti social, KOSTT e ka dëshmuar edhe duke ofruar mbështetje financiare për shkollim, duke siguaruar bursa për studentë dhe mbështetje financiare për kryerjen e praktikës profesionale për studentë.

Për të qenë një punëdhënës atraktiv dhe për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në punë, KOSTT ka investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve me realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese.

Duke pasë parasysh se një nga objektivat e kompanisë është edhe përgjegjësia në aspektin mjedisor, KOSTT ka treguar një përkushtim të vazhdueshëm, me largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese, duke i kushtuar rëndësinë e merituar

efiçencës së energjisë me përdorimin e materialeve termike, duke vazhduar me krijimin e hapësirave të reja për punë, hapësirave te gjelbëruara në NS, realizimin e projektit të Fasadës së Ndërtesës Administrative, gjë që tregon se edhe më tutje ka vazhduar përkujdesja ndaj ambientit të punës në tërësi.

Ndërlidhur me procesin e menaxhimit të cilësisë, është inicuar projekti për menaxhimin elektronik të dokumenteve dhe ky projekt pritet se realizohet plotësisht në vitin 2013.

KOSTT konsideron se gjatë kryerjes së veprimtarive të saj të përditshme, vend të veçantë zënë marrëdhëniet efektive me palët e interesit, e që njëkohësisht paraqesin një nga objektivat e saj strategjike. Prandaj, KOSTT edhe këtë vit ka vazhduar me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në rradhë të parë me aksionarët ( Qeverinë e Kosovës), me palët e interesuara e posaçërisht me ZRrE, donatorët (Komisioni Evropian, KfW,USAID, etj), OST-të fqinje, përdoruesit dhe më gjërë, por edhe me institucionet financiare relevante.

Me që KOSTT eksizton dhe vepron në rrethinën e vet afariste, ndryshimet që vijnë nga kjo rrethinë, domosdo, kanë reflektim dhe ndikim edhe në afarizmin e kompanisë.

Situatë të re në rrethinën afariste mund të paraqet shthurja dhe privatizimi i rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut.

Pritet që transferi i Shpërndarjes dhe Furnizimit te konsorciumi privat Çalik&Limak, të realizohet gjatë vitit 2013.

KOSTT-i për sa i përket rrjetit të transmisionit përveç te transformatorët 110/35 dhe 110/10(20)kV të transferuara nga KEK-u, në pjesën tjetër ka zhvilluar infrastrukturën e nevojshme për të u përgjigjur kërkesave të kompanisë private të Furnizimit dhe Shpërndarjes, që do të themelohet nga konsorciumi i lartëpërmendur.

Në rethinën afariste të KOSTT, do të ndikojë edhe kalimi i aseteve 400/220/110 kV dhe transformatorëve 220/35/10(20) kV dhe 110 kV, si dhe i fushave përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK sh.a në KOSTT, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, të datës 03 Gusht 2011. Kjo nënkupton domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve për të siguruar furnizim stabil dhe të sigurtë me energji elektrike gjatë dimrit të vitit 2012/2013. Kjo mund të mos jetë edhe aq e lehtë, pasi që investimet në nënstacionet 110 kV nga KEK nuk kanë qenë gjithnjë adekuate.

## 2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2012

| No. | Emri i Projektit | Buxheti | Financuar nga | Vlera e Kontratës | Data e fillimit | Data e kompletimit | Kontraktuesi | Buxheti i Planifikuar për 2012 | Buxheti i Realizuar për 2012 | Përqindja e realizimit 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ***Shërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV*** | 700,000.00 € | ECLO | 668,500.00 € | 17.12.2009 | 17.10.2011 | INGEDIA (Ro) | 4,129,904.00 € | 3,641,829.24 € | 88.18 % |
| | ***Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-1: NS 400/110 kV Ferizaj 2*** | 15,800,000.00 € | BK | 13,656,000.00 € | 24.12.2009 | 23.10.2012 | SIEMENS (At) | | | |
| | ***Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-2:LP ndërlidhëse 400 & 110 kV*** | 7,500,000.00 € | ECLO | 6,105,000.00 € | 31.12.2009 | 30.10.2011 | UMEL (B&H) | | | |
| 3 | **Paket Projekti SCADA/EMS (LOT1) & Telekomi (LOT2)** | 8,500,000.00 | BK | 7,875,370.00 € | 31.12.2008 | 30.06.2011 | Alstom/Komtel (F/RKS) | 1,155,960.00 € | 269,612.73 € | 23.32 % |

| Nr. | Emri i Projektit | Buxheti | Financuar nga | Vlera e Kontratës | Data e fillimit | Data e kompletimit | Kontraktuesi | Buxheti i Planifikuar për 2012 | Buxheti i Realizuar për 2012 | Përqindja e realizimit 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | **Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)** | 13,000,000.00€ (LOT 1, 2, 3) | ECLO | 634,000.00 € | 05.10.2010 | 11.072012 | INGEDIA (Ro) | 2,762,348.70 € | 2,762,348.70 € | 100 % |
| | ***Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)*** | | ECLO | 6,308,920.00 € | 10.01.2011 | 09.07.2012 | KONCAR (Hr) | | | |
| | **TI për Operatorin e Tregut (LOT2)** | | | 834,287.00 € | 10.01.2011 | 09.01.2012 | Siemens (At) | | | |
| 5 | ***Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3*** | 2,389,000.00 € | KOSTT | 1.959.800.80€ | 01.06.2011 | 20.12.2011 | ELSA& UKAB (Si/RKS) | 853,969.60 € | 149,658.40 € | 17.52 % |
| 6 | ***Kyçja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)*** | 1,050,000.00 € | KOSTT | 1,397,094.32 € | 27.06.2011 | 27.07.2012 | UMEL (B&H) | 1,009,400.93 € | 499,321.06 € | 49.47 % |

| Nr. | Emri i Projektit | Buxheti | Burimi i mjeteve | Vlera e Kontratës | Data e fillimit | Data e kompletimit | Kontraktues | Buxheti i Planifikuar për 2012 | Buxheti i Realizuar për 2012 | Përqindja e realizimit 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | *Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3* | 250,000.00 € | KOSTT | 168,880.32 € | 11.07.2011 | 02.01.2012 | KONCAR-KET (Hr) | 63,433.00 € | 54,081.84 € | 85.26 % |
| 8 | *Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)* | 150,000.00 € | KOSTT | 51,976.60 € | 25.09.2011 | 17.12.2011 | ELEGANCA (RKS) | 10,827.00 € | 10,827.00 € | 100 % |
| 9 | *Ndarja e zbarrave në dy seksione në NS Gjilani 1 dhe NS Therande* | 150,000.00 € | KOSTT | 36,951.57 € | 09.08.2011 | 27.01.2012 | Ukab (RKS) | 31,408.83 € | 29,561.25 € | 94.12 % |
| 10 | *Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1 - Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1* | 1,500,000.00 € | KOSTT | 3,267,253.00 € | 02.12.2011 | 29.06.2012 (120 ditë pune) | Ukab (RKS)/ELSA (Si) | 1,944,015.50 € | 927,514.41 € | 47.71 % |
| 12 | *Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV - Kosova B* | 250,000.00 € | KOSTT | 272,409.00 € | 12.12.2011 | 20.07.2012 (150 ditë pune) | Monting (RKS) | 272,490.00 € | 258,788.55 € | 94.97 % |

| Nr. | Emri i Projektit | Buxheti | Financuar nga | Vlera e Kontratës | Data e fillimit | Data e kompletimit | Kontraktues | Buxheti i Planifikuar për 2013 | Buxheti i Realizuar për 2012 | Përqindja e realizimit 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | ***Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit te lartë (TL) 110kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1*** | 1,150,000.00 € | KOSTT | 960,031.00 € | 18.02.2012 | 17.12.2012 | Enbi-Power (Al) | 672,021.70 € | 634,788.55 € | 95.80 % |
| 14 | ***Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110kV në NS Prizreni 2*** | 600,000.00 € | KOSTT | 551,998.00 € | 17.02.2012 | 03.08.2012 | Ukab (RKS) | 607,197.00 | 361,499.70 € | 59.54 % |
| 15 | ***LOT1: Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS Gjakova 2*** | 2,100,000.00 € | KOSTT | | | | | 630,000.00 € | 0.00 € | 0 % |
| | ***LOT2: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3*** | 2,100,000.00 € | KOSTT | | | | | | | |
| 16 | ***Furnizimi me softuerin E-Plan*** | 50,000.00 € | KOSTT | 34,105.86 | 14.11.2012 | 23.11.2012 | Komtel (RKS) | 50,000.00 € | 30,695.27 € | 61.39 % |
| 17 | ***Asfaltimi i rrugës së qasjes për në NS 400/110 kV - Peja 3*** | 150,000.00 € | KOSTT | 167,924.40 € | 13.06.2012 | 15.09.2012 (58 ditë pune) | Lika Trade (RKS) | 167,927.00 € | 182,925.62 € | 108.93 % |

| Nr. | Emri i Projektit | Buxheti | Financuar nga | Vlera e Kontratës | Data e fillimit | Data e kompletimit | Kontraktues | Buxheti i Planifikuar për 2012 | Buxheti i Realizuar për 2012 | Përqindja e realizimit 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | ***Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV - Kosova B & Instalimi i ndriçimit përgjatë saj*** | 450,000.00 € | KOSTT | | | | | 382,500.00 € | 0.00 € | 0 % |
| 19 | ***Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo*** | 100,000.00 € | KOSTT | | | | | 100,00.00 € | 0.00 € | 0 % |
| 20 | ***Instalimi i grupeve matëse sipas kufirit të rinj KOSTT/KEK (OSSH)*** | 2,200,000.00 € | KOSTT | | | | | 330,000.00 € | 0.00 € | 0 % |

## 2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Përpjekjet e KOSTT-it, edhe në të ardhmen, do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti), në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin.

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit, janë:

- Nevoja për adaptimet në zhvillimet e tregut të energjisë elektrike të Kosovës. Kjo kërkon aftësi shtesë dhe zhvillim të procedurave të reja, konform modelit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe në përputhje me afatet e caktuara kohore. Njëkohësisht kërkohet edukim për përdorimin dhe avansimin e platformave të ndryshme softuerike, të cilat mundësojnë aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesmarrëse në tregun e energjisë dhe që siguron operim më efiçient të sistemit elektrik. Në këtë drejtim, investimi në platforma të ndryshme softuerike është domosdoshmëri dhe njëkohësisht, aftësimi për përdorimin e tyre është obligues (Softuer për zbatimin e moduleve që janë në SCADA/EMS, Kontrolla Frekuncë Fuqi-LFC, Balancimi i sistemit elektrik, blerja e humbjeve nga tregje përfshirë edhe ato DACF- Day Ahead Congestion Forecast, Softuer për mbikqyrje të çastit, paisjeve të TL të tipit T5000, E-TERRA platforma softuerike)
- Eksploatimin maksimal të infrastrukturës për monitorim dhe kontroll, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese
- Krijimi i mundësive teknike në masë të konsiderueshme për realizimin e kontrollit të objeketeve të rrjetit transmetues nga Qendra Nacionale Dispeçerike Kryesore dhe Emërgjente
- Implementimi dhe azhurnimi i kodeve teknike
- Rritja e bashkëpunimit rajonal, nënshkrimi i marrëveshjeve të interkoneksionit, në përputhje me Ligjin e ri të Energjisë Elektrike dhe Politikave nga Doracaku i ENTSO-E dhe
- Operimi në nivel interkonektiv në përputhje me rregullat e ENTSO-E

Në aspektin e operimit gjatë planit afatmesëm do të implementohet edhe projekti i Kontrollit Frekuncë-Fuqi në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshoj regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në dy varianta:

- Operimi në një zonë të përbashkët me Shqipërinë;
- Operimi me dy zona të ndara por në një Bllok rregullues me Shqipërinë.

KOSTT-i si Operator i Tregut, sipas Ligjit të Energjisë Elektrike, është përgjegjës për propozimin e dizajnit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, përpilimin (draftimin ) e Rregullave të Tregut dhe dorëzimin e tyre për miratim në ZRrE. Operatori i Tregut është përgjegjës për implementimin e Rregullave të Tregut dhe udhëheq procesin e modifikimit të tyre, varësisht zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe rajon

KOSTT-i në kapacitetin e vet si Operator i Tregut dhe i Sistemit, do të sigurojë që të jetë plotësisht i integruar në të gjitha komponentet e tregut rajonal, të cilat aktualisht janë duke u zhvilluar. Në veçanti KOSTT-i duhet të:

- Përcjellë zhvillimet në rajon rreth tregut të energjisë elektrike
- Luaj rolin e plotë në vendim marrje për zhvillimin e mekanizmave të tregut, përfshirë modifikimin e rregullave dhe procedurave të tregut të cilat do të mbështesin modelin aktual të tregut të nënshtruara miratimit rregullator;
- Të përmbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë
- Të jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut;
- Sigurojë që të gjitha kërkesat e operimit rajonal mund të përmbushen, posaçërisht standardet e ENTSO-E dhe cilitdo pasardhës tjetër të mundshëm ;
- vendosë marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të (Operatorët e Sistemit të Transmisionit) fqinje;
- Zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal; dhe
- Kontribuoj në punën e CAO (Coordinated Auction Office ) ku KOSTT është një nga themeluesit dhe aksionarët.

Njëra nga objektivat strategjike të definuara në Planin e Biznesit të KOSTT, është përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj. Për ta plotësuar përgjegjshmërinë nga aspekti social, KOSTT do të sigurojë se do të kujdeset për shëndetin e punëtorëve dhe do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe do të përgatiten projekte konkrete për mbrojtjen e shëndetit për punëtorët e saj. Për këtë qëllim, KOSTT ka realizuar projektin e sigurimit shëndetësor suplementar, gjegjësisht sigurimin shëndetësor ndaras nga sigurimi shëndetësor shtetëror për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë.

Sigurimi shëndetësor do të ndikojë në motivimin e punëtorëve për punë dhe me këtë, KOSTT do ta përmbush objektivën strategjike, për të qenë punëdhënës atraktiv. Mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin e punëtorëve gjithashtu do të ndikojë edhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

KOSTT njeh prioritetin e lartë që duhet ta ketë mbrojtja e mjedisit në Kosovë dhe më gjërë. Aplikimi i sistemit të udhëheqjes me mjedisin dhe certifikimi sipas normës ISO 14001:2004 janë parakushte për përparim të vazhdueshëm të raporteve ndaj mjedisit. KOSTT-i në vitin 2013 synon këtë çertifikim(me mundësi të vazhdimit edhe në vitin 2014). Me aktivitetet për aplikimin e sistemit të udhëheqjes me mjedisin KOSTT ka filluar që në vitin 2009. Norma Ndërkombëtare ISO 14001:2001 sot është standardi më i përparuar për udhëheqjen me mjedisin i cili është i zbatueshëm në secilën ndërmarrje e cila dëshiron ta aplikojë, mirëmbajë dhe pandërprerë ta përmirësojë sistemin e vet të udhëheqjes me mjedisin. Zbatimi i një qasjeje të tillë nga ana e ndërmarrjes, është proces vullnetar.

Përmes procesit të çertifikimit të sistemit të udhëheqjes me mjedisin dhe sigurinë priten efekte pozitive siç janë: përmirësimet e gjendjes në perimetrin mjedisor dhe të sigurisë vetanake, investimet më racionale në projektet e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë, si dhe shumë efekte tjera të ngjashme. Nga ana tjetër, synohet një avancim në raport me institucionet kompetente, duke bërë ngritjen e përgjegjësisë dhe vetëdijes mbi mbrojtjen e

mjedisit dhe të sigurisë në tërësi, si dhe duke përmirësuar pasqyrën afariste ndaj publikut të gjërë, gjë që i kontribuon përmbushjes së synimeve themelore afariste të KOSTT-it.

Me këtë qasje KOSTT-i si ndërmarrje publike bëhet anëtar i përhershëm, i vetëdishëm dhe i përgjegjshëm i mbarë mesit në të cilin vepron si dhe përmes sistemit që aplikon, ta përparojë cilësinë e jetës në mjedisin e drejtëpërdrejtë si dhe ate në nivelin global.

## 2. 7. Rreziqet

Rreziqet e mundshme si pasojë e ndikimeve që vijnë nga jasht, respektivisht nga rrethina afariste, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT.
Në vazhdim janë analizuar dhe identifikuar disa nga këto rreziqe:

- pengesat e integrimit të KOSTT-it në proceset rajonale të motivuara politikisht dhe si pasojë mos dhënja e EIC kodit me shenjen "Y" , si zonë tregtare apo zonë rregulluese nga ana e ENTSO-E, gjë që pamundëson nominimet e programeve ndërkufitare të energjisë elektrike;
- vështirësitë financiare nga mosinkasimi i të hyrave;
- tregu financiar për sigurimin e mjeteve për investime kapitale;
- risku rregullator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- pamundësia e operimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një pjese të rrjetit transmetues të Kosovës, për shkak të ndërhyrjes ilegale të Operatorëve serb EMS dhe EPS.
- Pamundësia e qasjes për mirëmbajtje në NS Vallaq, si NS që paraqet një nyje shumë të rëndësishme elektroenergjetike, mund të shkaktojë rënie të padëshiruara dhe në këtë mënyrë zvogëlohet siguria e furnizimit me energji elektrike ne disa nga NS-të e kësaj unaze
- Gjendja e aseteve të transferuara nga KEK-u
- kriza globale

Vështërsitë do të paraqiten, sepse parashtrohet çështja se kërkesave të tregut të energjisë elektrike, a do të mund të i përgjigjen gjithë ata që do të aderojnë në këtë treg. Më e theksuar si problematikë do të jetë balancimi si mekanizëm i domosdoshëm që duhet të implementohet

Në mënyrë që të ulet ndikimi në secilin rrezik, duhet ndërmirren veprimet:

- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EMS dhe anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur në ENTSO-E;
- Ndërrimi i regjimit të operimit të rregullimit të sistemit nga ai i Serbisë në atë vetjak dhe në bashkëpunim me Shqipërinë;
- Marrja e masave juridike për eliminimin e rreziqeve të arkëtimit të hyrave;
- Avancimi i operimit i sistemit të transmisionit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektroenergjetik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privat të gjenerimit dhe furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;

Implementimi efiçient i investimeve kapitale të KOSTT-it

# Aneks

## 1. Sponzorimet dhe donacionet

Gjatë vitit 2012 KOSTT ka ndarë 12,000.00 € në emër të bursave për studentët e Universitetit të Prishtinës dhe 900.00 € për Universitetin Publik "Haxhi Zeka" në Pejë

Përveç kësaj, ka sponzoruar edhe institucionet në vijim:

- Odën Ekonomike të Kosovës me 1, 000.00 euro
- Fondin Kosovar-Amerikan për edukim (KAEF) me 5,000.00 euro
- Fondacionin " Fëmijët e Kosovës" me 4,000.00 euro dhe
- Ndihma për fëmijët me kancer me 4,000.00 euro.

Vlera totale e sponzorimeve është 26,900 euro.

## 2. Raporti i Zyrtarit për Auditim të Brendshëm

### Përmbledhje e përgjithshme:

Zyrtari për Auditim të Brendshëm e ka ushtruar funksionin e tij sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, procedurave dhe standardeve të cilat janë në funksion të auditimit të brendshëm.
Për vitin 2012 është përgatitur Plani i auditimit te brendshëm dhe është prezantuar pranë Komisionit të auditimit i cili është aprovuar në përputhshmëri të plotë me standardet e auditimit.
Objektivat, aktivitet, dhe përgjegjësit e zyrtarit për auditim të brendshëm gjatë vitit 2012 janë zhvilluar në bazë të planit strategjik dhe vjetor për auditim të brendshëm, i cili është i aprovuar nga Komisioni i auditimit.

Zyrtari i auditimit të brendshëm i përmbahet planit strategjik sipas të cilës plani vjetor i auditimit e disponon rolin kryesor në rritjen e efikasitetit dhe përmbushjen e misionit mbi objektivat e parapara.

Plani vjetor i auditimit është përpiluar në bazë të prioriteteve, analizave dhe vlerësimeve në riskun e një sfere përkatëse, dhe në bazë të këtyre vlerësimeve janë përzgjedhur edhe departamentet dhe sektorët përkatës për procedura audituese.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona për auditimet e zhvilluara, janë ndërmarrë aktivitete si në vijim:

- Është kryer vlerësimi për funksionimin e kontrollës së brendshme;

- Testimi në nivelin e zbatueshmërisë së planeve mujore dhe vjetore të transaksioneve me ndikim material;
- Testimi i shkallës së zbatueshmërise së ligjeve, politikave, procedurave dhe rregullave përkatëse;
- Përcaktimi i mostrimeve sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e transaksioneve;
- vlerësimet për realizimin e planeve zhvillimore, biznesore, buxhetore, dhe strategjike;
- testimet substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- është praktikuar një kombinim i intervistave, rishikimeve analitike, rishikim dokumentacioni;
- ekzaminimet fizike për të vlerësuar menaxhimin e pasurisë;
- testimet mbi bilancet vjetore dhe afatgjata të energjisë;
- testimet mbi nivelin e përmbushjes së implementimit të rekomandimeve.

Gjatë vitit 2012 janë përgatitur 5 raporte, këto raporte janë dorëzuar te Komisioni i auditimit konformë rregullave dhe procedurave për auditim të brendshëm. Në raportet e auditimit të brendshëm janë prezantuar aktivitet, objektivat, të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.

## Konstatimi për raportet dhe rekomandimet

Gjatë vitit 2012 janë kryer auditime në bazë të plan-programit dhe objektivave të paraqitura, po ashtu aktivitet e aplikuara janë në nivel të përgjegjësisë mbi rriskun, të cilat menaxhmenti duhet të veprojë në përmirësimin apo zvogëlimin e tyre.

Në kuadër të plan programit mbi aktivitet audituese janë audituar 5 departamente ku në këto departamente janë përfshirë 15 sektorë të cilët janë përzgjedhur në bazë të detyrave dhe përgjegjësive me ndikim më të lartë në sistemin menaxhues.
Gjatë auditimit janë testuar, ekzaminuar çështjet me ndikim më të lartë, ku në varshmëri të procesit të auditimit janë dhënë rekomandime të prezantuara në raporte dhe këshilla gojore të ndryshme, varësisht nga natyra e kërkesave të personelit përkatës.

Konstatojmë që të gjeturat nuk kanë qenë në shkallë materialiteti apo në nivelin e dyshimit për mashtrim, keqpërdorim apo fshehje të informacioneve.

Departamentet e audituara, dhe shkalla e implementimit të rekomandimeve

| Nr. | Departamentet | Implementimi i rekomandimeve |
|---|---|---|
| 1. | Operimi i Sistemit | 10 |
| 2. | Burimeve Njerëzore | 11 |
| 3. | Menaxhimit te Projekteve | 5 |
| 4. | Financave | 8 |
| 5. | Prokurimit | 5 |

Raportet paraqesin nivelin kyç për adresimin e këshillave për të ngritur nivelin e përmirësimit për dobësitë, gabimet apo paqartësitë të cilat ndodhin në Ndërmarrje. Në përgjithësi, auditimi ka ndikuar në zhvillimin pozitiv, në ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të Ndërmarrjes.
Ekzekutivi ka treguar progres në përmirësimin e sistemit mbi mjedisin e kontrollit, zbatimin e procedurave, ligjeve dhe rregullave përkatëse, gjithashtu ka treguar një bashkëpunim të mirë duke marrë për bazë këshillat të cilat janë në dobi dhe zhvillim të Ndërmarrjes.
Raportimi i të gjeturave në kohë dhe cilësi është një mbështetje për Ndërmarrjen që të sigurojë llogaridhënie në cilësinë e menaxhimit dhe funksionimit të saj.

Gjatë vitit, menaxhmenti ekzekutiv përkatësisht departamentet përkatëse kanë përgatitur planet për veprim mbi implementimin e rekomandimeve dhe ne kemi aplikuar testime matëse mbi shkallën e zbatueshmërisë së implementimit të tyre, të cilat janë të prezantuara dhe në tabelën përkatëse.

Të gjitha rekomandimet e prezantuara mund të thuhet që i përkasin një natyre mbi forcimin e kontrollës së brendshme, nivelin e përgjegjësisë, eliminimin e gabimeve apo paqartësive në funksion të përmirësimit të sistemit. Në bazë të kësaj, konstatojmë se ka avancime pozitive në implementimin e rekomandimeve të cilat janë në interes të Ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2012 kemi dhënë rekomandime konstruktive në përmirësim e dobësive dhe kjo ka dhënë rezultate pozitive në funksion të zhvillimit te progresit të Ndërmarrjes. Ne përcjellim nga afër mënyrën se si adresohen rekomandimet tona dhe vazhdojmë të punojmë në partneritet të ngushtë me stafin përgjegjës të nivelit ekzekutiv.
Ne do të punojmë në mënyre të vazhdueshme duke paraqitur këshilla më të dobishme në funksion të Ndërmarrjes.

## 3. Formulari i vetvlerësimit të Bordit të Drejtorëve

| | Vetë-vlerësimi i Bordit | Komenti |
|---|---|---|
| **A. Aktivitetet e Bordit** | | |
| 1. Kur ka filluar aktivitetin Bordi, gjegjësisht kur është mbajtur mbledhja e parë e Bordit? | Mbledhja e parë e Bordit është mbajtur me 2 Qershor 2009 | |
| 2. Sa anëtarë ka Bordi i Drejtoreve duke përfshirë edhe Kryeshefin Ekzekutiv të NP? | Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka pasur 7 anëtarë të Bordit. Ndërkohë një anëtar i Bordit ka ndërruar jetë dhe Bordi ka mbetur me 6 anëtarë | |
| 3. Sa mbledhje ka mbajtur Bordi i Drejtorëve gjatë këtij viti? | Gjatë vitit 2012 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 10 (dhjetë) mbledhje të rregullta dhe 1 (një) mbledhje të jashtëzakonshme | |
| 4. A është takuar Bordi aq shpesh sa janë paraqitur kërkesat për çështjet e NP-ve? | PO.<br>Bordi është takuar aq shpesh sa janë paraqitur kërkesat. Gjatë vitit 2012 Bordi i KOSTT-it është takuar bazuar në Planin e Punës së KOSTT-it dhe nevojat e KOSTT-it. Bordi ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 1 takim për vetëvlerësim. | |
| 5. A kanë punuar anëtarët e Bordit në mënyrë efikase si ekip, për t'i zgjidhur në mënyrë të kënaqshme mospajtimet? | Po.<br>Bordi ka punuar në mënyre efikase si ekip.<br>Të gjitha çështjet e diskutimit gjatë mbledhjeve janë harmonizuar dhe Bordi ka vendosur në mënyrë unanime. | |

| | | |
|---|---|---|
| | operojmë në mënyrë sinkrone, gjë e cila do të mundësonte ndër të tjera edhe pjesëmarrjen në mekanizmat e përbashkëta që valorizojnë çdo transaksion ndërkufitar. Valorizimi i aranzhmaneve ndërkufitare mund të sjellë të hyra në dobi të KOSTT-it dhe konsumatorë të Kosovës. Mospranimi i mundshëm i KOSTT në ENTSO –E është një rrezik i mundshëm.<br><br>Menaxhmenti i KOSTT-it ka njoftuar Bordin për të gjitha rreziqet dhe Bordi i jep përkrahje të plotë KOSTT-i | |
| 9. A i ka miratuar Bordi, Kodin e Etikës dhe Qeverisjën Korporative? | Po<br><br>Bordi ka aprovuar Kodin e Etikës dhe Qeverisjen Korporative. | |
| 10. A i kane nënshkruar zotimet për respektimin e Kodit dhe Ligjit të gjithë anëtarët e BtD? | Po.<br>Zotimet për respektimin e Kodit dhe Ligjit janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarët e Kompanisë. | |
| 11. A i'u ka referuar Bordi kodit të etikës dhe qeverisjes korporative të ndërmarrjes? A janë paraqitur çështje të cilat nuk kanë qenë në kod? Çfarë veprime ka marrë Bordi? | Po.<br>Bordi i KOSTT-it nuk ka pasur rast që të adresojë ndonjë çështje që ndërlidhet me Kodin Etik dhe Qeverisjen Korporative, prandaj nuk ka pasur nevojë për ndonjë veprim konkret. | |
| 12. A ka pranuar Bordi ndonjë koment nga Aksionari- NJPMNP mbi rishikimin e ndonjë vendimi? Nese po, a i ka shqyrtuar Bordi komentet dhe a është njoftuar aksionari- NJPMNP? | Po.<br>Bordi i KOSTT-it ka marrë udhëzime nga Aksioanari për anulimin e të gjitha vendimeve për themelimin e komisioneve të përkohshme dhe Bordi ka vepruar në pajtim me udhëzimin duke i anuluar të gjitha vendimet e përmendura. | |
| 13. A ka miratuar Bordi i Drejtorëve Planin e Biznesit para 31 Tetorit? | PO<br>Bordi i Drejtorëve ka miratuar Planin e Biznesit për vitin 2013 para 31 Tetorit të vitit 2012. | |
| 14. A ka miratuar Bordi i Drejtorëve | PO | |

| | | |
|---|---|---|
| raportin mbi kënaqësinë e konsumatorit sipas nenit 28 të Ligjit? | Bordi i Drejtorëve ka miratuar Raportin mbi Kënaqësinë e Konsumatorëve sipas nenit 28 të Ligjit. | |
| 15. A ka miratuar Bordi i Drejtorëve raportet tremujore dhe vjetore sipas nenit 31 të Ligjit? | Po<br>Bordi i Drejtorëve ka miratuar Raportet tremujore sipas afatit ligjor dhe sipas kërkesave nga neni 31 i Ligjit | |
| 16. A ka respektuar Bordi i Drejtorëve vendimin e Qeverisë mbi lartësinë e kompensimit të Bordit të Drejtorëve? | Po<br>Bordi i Drejtorëve ka respektuar vendimin e Qeverisë mbi lartësinë e kompensimit të Bordit të Drejtorëve | |
| 17. Në këndvështrim, çfarë ka bërë Bordi që nuk është dashur të bëjë? | Deri tani Bordi i ka ndërmarrë të gjitha veprime që janë kërkuar bazuar në Ligjin e NP-ve dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen në këtë drejtim. | |
| **B. Komitetet e Bordit** | | |
| 1. Cilat Komitete të Bordit kanë qenë aktive gjatë kësaj periudhe? *(listojë ato)* | Gjatë vitit 2012 Bordi ka qenë i asistuar kryesisht nga Komisioni i Auditimit. Bordi gjithashtu ka qenë i asistuar edhe nga Komisioni për Projekte kapitale dhe Komisioni për ndërtimin e Linjës 400 kV Kosovë- Shqipëri, Komisioni për investime kapitale, komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore, komisioni për shqyrtimin e operimit.<br><br>Komisioni i Auditimit ka kontribuar shumë në punën e Bordit pasi ka bërë shqyrtime dhe rekomandime në pothuajse çdo dokument që është vlerësuar nga Bordi – Politikat e KOSTT-it, Raportet tremujore, Raportin vjetor, Buxhetin, Pasqyrat financiare. Komisionet tjera kanë qenë ndihmë për Bordin pasi paraprakisht kanë përcjellë aktivitetet e ndërlidhura. Kjo ka qenë një lehtësim për Bordin pasi shqyrtimi paraprak ka qenë i dobishëm. | |
| 2. Kur Aksionari ka formuar Komitetin e Auditimit? | Komisioni i Auditimit është formuar në të njëjtën kohë kur edhe Bordi i Drejtorëve dhe ka filluar punën menjëherë. | |
| 3. Kur ishte mbledhja e parë e Komitetit | Mbledhja e parë e Komisionit të auditimti është mbajtur në vitin 2009. | |

| | | |
|---|---|---|
| të Auditimit? | | |
| 4. A mbajti mbledhje Komiteti i Auditimit tri ditë para çdo mbledhje të Bordit të Drejtoreve? | Po. Mbledhjet e Komitetit mbahen së paku tri ditë para mbledhjes së BD, përveç mbledhjeve të jashtëzakonshme të BD, | |
| 5. A shqyrtoi në mbledhjet e veta Komisioni i Auditimit të gjitha raportet që kërkohen me Ligj? | Po<br>Komisioni i Auditimit i ka shqyrtuar të gjitha raportet tre-mujore, vjetore dhe për kënaqësinë e konsumatorëve sipas kërkesave Ligjore. | |
| 6. A ka miratuar Komiteti i Auditimit Deklaratën mbi Politikën e Kompensimit? | PO<br>Komisioni i Auditimit e ka propozur Deklaratën mbi Politikën e Kompensimit të cilën e ka aprovuar Bordi bazuar në ligjin për NP | |
| 7. Cili Komitet i Bordit ka kontribuar më së shumti për të përmirësuar performancën në këtë periudhë? | Komiteti i Auditmit | |
| 8. Cili Komitet i Bordit mund të shpërndahet pa pasur ndonjë humbje? | Të gjitha komisionet e përkoshme japin kontribut të ndjeshëm në lehtësimin e punës së Bordit dhe si të tilla janë të dobishme. | |
| 9. Cilat rekomandime të rendësishme janë formuluar nga komitetet dhe i janë referuar Bordit për miratim? | Komisioni i Auditimit i ka shqyrtuar dhe rekomanduar Bordit për aprovim të gjitha dokumente që Bordi i ka shqyrtuar dhe aprovuar.<br>Komisioni i ka vlerësuar të gjitha raporte tremujore dhe raportin vjetor të vitit 2012, raportin e auditorit të jashtëm në KOSTT, raportet e auditorit të brendshëm, propozim Buxhetit për vitin 2013, Planin e Biznesit për vitin 201.3, politikat, Planin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2013, Planin e prokurimit dhe raporte të tjera | |
| **C. Veprimet** | | |
| 1. Cilat janë veçoritë kryesore operative që e brengosin Bordin dhe çfarë hapa ka ndërmarrë Bordi deri më sot për t'i adresuar këto çështje? | Bordi ka vlerësuar çështjen e pazgjidhur të alokimit të kapaciteteve interkonektive dhe transitit me vendet fqinje si pasojë e marrëdhënieve të pazgjedhura me Serbinë. Bordi ka ofruar përkrahjen e tij në të gjitha rastet kur kjo nevojitet. | |

| | | |
|---|---|---|
| | Gjithashtu KOSTT ka informuar Bordin në lidhje me mospagesën e faturave nga ana e KEK-ut.<br><br>KOSTT nuk është duke e kontrolluar plotësisht operimin e transmisionit në pjesën veriore të Mitrovicës si pësojë e mosdëgjueshmërisë së operatorëve në nënstacionin Vallaq dhe involvimit jolegale të operatorit të sistemit EMS nga Serbia.<br><br>Menaxhmenti i KOSTT-it e ka njoftuar Bordin dhe Ministritë përkatëse. Bordi ka përkrahur veprimet e KOSTT-it. | |
| 2. Çfarë ka bërë Bordi për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve të ndërmarrjes? | Bordi i KOSTT-it ka diskutuar rrethanat e reja të mundshme që do të krijohen me privatizimin e operatorëve KEK Distribucion dhe Furnizim si dhe Gjenerim dhe ka sugjeruar Menaxhmentin e KOSTT-it që të përgatitet për veprime në rrethana të reja. Operatori i Tregut në kuadër të KOSTT-it duhet t'i shtojë aktivitetet në këtë drejtim.<br><br>Bazuar në Planin e Biznesit KOSTT-i ka përfunduar projektet që ndikojnë në mënyrë pozitive në operimin e sistemit si ç janë:<br>a. Projekti për rehabilitimin e NS Prizreni;<br>b. Projekti- ndërtimi i nënstacionit NS 400/110 kV – Ferizaj 2 dhe projekte të tjera investive – kapitale.<br>KOSTT-i është në procesin e implementimit të Projektit -ndërtimi i linjës 400 kV Kosovë Shqipëri | |
| 3. A ka patur intervenime individuale të anëtarëve të Bordit? | Jo | |

| | | |
|---|---|---|
| 4. A ka patur tentime për përzierje të Bordit në mikromenaxhim, në rekrutim të personelit, apo në prokurim? | Jo | |
| 5. Çfarë ankesa nga jashtë i janë referuar Bordit dhe si i ka zgjedhur Bordi ato? | Nuk ka pasur ankesa | |
| 6. A i ka konsideruar (shqyrtuar) Bordi ndryshimet në faktorët e jashtëm të cilat mund të përmirësojnë performancën e ndërmarrjes? Dhe çfarë hapa ka ndërmarrë Bordi për t'i përmirësuar këto ndryshime? | Po<br>Shih përgjigjën nën numrin C.2 .<br>Bordi rregullisht ka pranuar informata nga Menaxhmenti i KOSTT-it në lidhje me të gjitha pengesat ose brengat | |
| **D. Baza e aseteve fizike** | | |
| 1. A janë kërkuar më shumë investime kapitale dhe nëse "po":<br>(a) Për çka (në përgjithësi –dhe sipas prioriteteve);<br>(b) Sa (përafërsisht);<br>(c) Kush do të paguajë për këto investime? | Po.<br>Bordi ka aprovuar Planin e Biznesit dhe Buxhetin ku janë përfshirë të gjitha projektet investive të KOSTT-it, që janë parashikuar për periudhën përkatëse. Investimet kapitale janë nga programi i zhvillimit të sistemit të transmisionit (rrjet, sisteme kontrolli dhe monitorimi). Sipas Planit të Biznesit për vitin 2013 KOSTT parasheh investimin në projekte kapitale në shumën prej rreth 36milionë euro | |
| 2. Cilat ndryshime teknologjike mund të miratohen për të përmirësuar shërbimet dhe performancën në ndërmarrje? | Bordi ka përkrahur projektet sipas planit të biznesit, projekte të cilat do të kanë ndikim të drejtëpërdrejtë siç janë projeketi për grupet matëse në kufirin e ri ndërmjet transmisionit dhe distribucionit, integrimi i objekteve në reja në SCADA EMS, etj. | |
| **E. Kapitali njerëzor** | | |
| 1. A janë duke punuar punonjësit me efikasistet maksimal? Nëse jo, cilat janë | Po. Punonjësit punojnë me efikasitet maksimal. | |

| | | |
|---|---|---|
| fushat dhe arsyet e deficitit? | | |
| 2. A bazohet pasuria njerëzore në terma të dijes, përvojës dhe aftësive? | Po. KOSTT ka përafërsisht 30.5 % punonjës me kualifikim superior të trajnuar dhe me shkathtësi të shkëlqyeshme dhe motivim të kënaqshëm. | |
| 3. A e ka vlerësuar Bordi performancën e anëtarëve të ekipit të menaxhmentit? Në përgjithësi cilat ishin konkluzionet e tij? | Po.<br>Bordi ka vlerësuar pozitivisht performacën e Zyrtarëve të lartë të KOSTT-it në mënyrë pozitive | |
| 4. A i ka shqyrtuar Bordi – ose a i ka inicuar – ndryshimet në personel me qëllim që të përmirësojë performancën? | Po Bordi ka shqyrtuar këtë çështje.<br><br>Pasi performanca e KOSTT-it është pozitive Bordi nuk ka bërë ndërhyrje në personel. Personeli i KOSTT-it ka treguar përgjegjësi dhe kualitet të lartë në kryerjen e të gjitha aktiviteteve. | |
| 5. A është i kënaqur Bordi që ndërmarrja është konkurrente në terma të politikave të personelit të saj duke përfshirë shpërblimet? | Po.<br>Bordi është i mendimit së Politikat e personelit duke përfshirë Politikat e Kompensimit të KOSTT-it janë të kënaqshme. | |
| **F. Financat** | Po.<br>Meqenëse drejtorët në Bordin e KOSTT-it kanë përvojë të gjatë në qeverisje dhe ekonomi, në mënyrë të përgjegjshme i interpretojnë pasqyrat financiare dhe Raportet e Audituara. Nuk ka fusha me vështërsi për Bordin e tanishëm. | |
| 1. A është secili Drejtor në gjendje t'i lexojë dhe interpretojë pasqyrat financiare të ndërmarrjes dhe raportet e auditorëve të jashtëm? Cilat janë fushat me vështirësi? | | |
| 2. A është Bordi i kënaqur me performancën financiare në lidhje me: (a) buxhetin vjetor; dhe (b) ambientin biznesor. | Po.<br>Bordi i KOSTT-it është i kënaqur me perfomancën financiare dhe buxhetin vjetor të KOSTT-it. | |

| | | |
|---|---|---|
| 3. A planifikon Bordi të ndalojë kërkesat për subvencione dhe/ose grante kapitale në Qeveri? | Po.<br>Bordi planifikon që për një periudhë afatshkurtër të ndalojtë kërkesat për grante kapitale në Qeveri. Bordi planifikon uljen graduale të granteve dhe zëvendësimin e tyre me kredi komerciale duke iu referuar zhvillimit të tarifës së shërbimeve të KOSTT-it | |
| 4. A është e duhur struktura tarifore e ndërmarrjes për vitin e ardhshëm dhe më tutje? Cilat ndryshime (nëse ka ndonjë) do t'i rekomandojë Bordi? | Bordi përkrah metodologjinë për tarifa e cila është në procesin e hartimit nga menaxhmenti i KOSTT. | |
| 5. A e ka ndërmarrja kapitalin adekuat të punës? Nëse "jo" radhitni vendimet e marra nga Bordi për të zgjidhur këtë problem. | Po.<br>Sa i përket shpenzimeve operative, KOSTT-i ka kapital të mjaftueshëm ndërsa për projekte kapitale ka idenfitikuar burimet e financimit. | |
| **G. Pronësia** | | |
| 1. A e konsideron Bordi strukturën e tanishme të pronësisë të jetë pengesë për performancën optimale? Nëse "po", çfarë propozime ka bërë Bordi për ta zgjidhur këtë? | Po Bordi ka konsideruar këtë çështje.<br><br>Bordi konsideron se struktura e tanishme e pronësisë është adekuate për perfomancën optimale. | |
| 2. A i ka shqyrtuar Bordi pengesat e investitorëve në sektorin privat dhe/ose operatorëve? Cilat janë ato pengesa? | N/A | |
| 3. A ka bërë Bordi ndonjë propozim për të inkurajuar involvimin e sektorit privat; dhe në çfarë mënyra? | N/A | |
| 4. A e ka shqyrtuar Bordi bashkimin e | N/A | |

| | | |
|---|---|---|
| mundshëm ose përvetësimet? Nëse është përballur me këtë opsion, përmbledhi pikëpamjet e Bordit. | | |
| 5. A e konsideron Bordi që aksionarët e tanishëm janë të kënaqur me performancën e Bordit? Çfarë shqetësime mund të kenë aksionarët? | Po.<br>Bordi konsideron se Aksionarët janë të kënaqur pasi KOSTT-i ka treguar perfomancë në ngritje. | |
| 6. A ka pasur Bordi ndërlidhje të mjaftueshme me aksionarët që të jetë në gjendje t'i matë pikëpamjet e aksionarëve për politikat e tanishme biznesore? Nëse "jo", pse? | Po.<br>Bordi ka komunikuar me aksionarët nëpërmjet të NJPMNP dhe ministrive përkatëse | |
| **H. Planifikimi** | | |
| 1. A është Bordi i kënaqur me procesin e planifikimit të biznesit dhe çfarë përmirësime mund të bëhen? | Po.<br>Planifikimi i Biznesit bëhet bazuar në Planin e Biznesit pesë –vjeçar (2007 - 2013) dhe planit vjetor të biznesit. Në vitn 2013 Bordi parashef miratimin e planit pesëvjeçar të biznesit për periudhën e ardhshme 2013-2017. | |
| 2. A është përgatitur plani i biznesit me kohë? | Po.<br>Plani i Biznesit është aprovuar nga Bordi me kohë | |
| 3. A është aprovuar plani i biznesit nga ana e Bordit deri më 31 Tetor? | Po.<br>Bordi e ka aprovuar Planin e Biznesit para afatit ligjor 31 Tetor 2012. | |
| 4. Çfarë plane të veprimeve janë ndërmarrë nga Bordi në përcaktimin e planit të tanishëm biznesor? | Bordi në vazhdimësi përcjellë zbatimin e planit të biznesit dhe e krahason atë me periudhat paraprak, sipas nevojës plani i biznesit dhe buxheti revidohen pas miratimit të tarifave të energjisë elektrike. | |
| 5. A bën Bordi planifikime afat-gjata? | Po.<br>Bordi aprovon planet afatgjata, duke përfshire edhe ato strategjike të zhvillimit dhe i rishqyrton ato në baza vjetore me rastin e aprovimit. Bordi | |

| | | |
|---|---|---|
| | vepron bazuar në Politikën për punën e Bordit dhe të Komisioneve, të aprovuar nga Bordi | |
| 6. Cilat çështje e vështirësojnë planifikimin dhe çfarë ka bërë Bordi për t'i adresuar këto? | Planifikimin e vështirëson fakti se viti tarifor (prill 2012- prill 2013) nuk përputhet me vitin afarist dhe kjo vështirëson planifikimin e aktiviteteve në KOSTT-it pasi planifikimi bëhet për vitin afarist e jo tarifor. | |
| 7. A është i kënaqur Bordi me procesin e buxhetimit? Cilat përmirësime mund të bëhen? | Po.<br>Bordi është i kënaqur me procesin e buxhetimit që rrjedh nga parametrat e të hyrave të lejuara nga ZRrE dhe ka aprovuar Pasqyrat financiare për vitin 2011 të audituara pa kualifikime. | |
| 8. A janë me kohë në dispozicion të Bordit raportet tremujore të performancës? | Po.<br>Raportet tremujore i dorëzohen së pari Komisionit të Auditimit i cili i shqyrton dhe rekomandon Bordit aprovimin e tyre. Pas aprovimit nga Bordi, raportet dërgohen në NJPMNP me kohë. | |
| 9. A e krahasojnë raportet tremujore performancën aktuale me buxhetin dhe a i sqarojnë mospërputhjet? | Po.<br>Raportet tremujore përherë krahasojnë performancën financiare aktuale me buxhetin dhe sqarojnë mospërputhjet të cilat gjatë vitit 2012 gjithnjë kanë qenë pozitive. | |
| 10. A ka përfitime materiale te anëtareve përveç atyre qe Qeveria ka lejuar me Vendim? | Jo<br>Bordi nuk ka asnjë përfitim material përpos të ardhurave që janë përcaktuar nga Qeveria | |
| 11. A ka konflikt të interesit në kompani nga anëtaret e Bordit? | Jo | |
| **I.Vlerësimi i Përgjithshëm i Bordit** | | |
| 1.Përshkrimi i Vlerësimit të Përgjithshëm | | |
| 2. Vleresimi sipas notave duke filluar nga 1 deri ne 5 | | |

| | | |
|---|---|---|
| Nënshkruar nga:<br><br>Kryesuesi:<br><br>Sekretari i Kompanisë:<br><br>Më: | | |

# 4. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike

## 4.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2012

Struktura organizative e KOSTT-it e përbërë nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit.

Afarizmi i KOSTT zhvillohet nga 8 (tetë) Departamente, 3 (tri) Zyre të përbëra në strukturën e Drejtorisë Qendrore. Në strukturën e KOSTT janë të përfshirë edhe pozitat e Kryeshefit Ekzekutiv, 2 (dy) Zëvendës të KSHE, njeri me përgjegjësi për operim ndërsa tjetri për zhvillim, Sekretarit të Kompanisë, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Trezorit, si dhe Zyrtarit për Auditimin e Brendshëm.

Organizimi i KOSTT është bazuar në afarizmin themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet:

- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, komercial, rregullativ, ligjor, marrëdhënieve me punëtorë, administrativ, zhvillimit të personelit, teknologjisë së informacionit dhe zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:

- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat
- Burimet Njerëzore dhe
- Prokurimit

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë
- Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun dhe
- Zyra për Siguri Industriale dhe Mjedis

**Numri i Punëtorëve**

Me datën 1 Janar 2012 numri i punëtorëve në KOSTT ka qenë 242, ndërsa më 31 Mars 2012 numri i përgjithshëm i të punësuarve ka rënë në 239.

Arsye e lëvizjes së numrit të punëtorëve ishte pensionimi i tre (3) punëtorëve dhe pushimi pa pagesë për një punëtor.

Nga 1 Prill 2012 numri i punëtorëve në KOSTT ka arritur në 370, për shkak të transferimit të 130 punëtorëve nga KEK në KOSTT, sipas Vendimit të Qeverisë dhe Marrëveshjes së nënshkruar. Është pranuar një punëtore në pozitën - Specialist për mbrojtje të mjedisit, dy (2) punëtorë janë pensionuar dhe një (1) punëtores i është ndërprerë marrëdhënia e punës me kërkesën e saj.
Më 30 qershor 2012 numri i përgjithshëm i të punësuarve ishte 367

Gjatë tremujorit të tretë numri i punëtorëve është rritur për dy (2) sepse kanë filluar punën dy punëtorë të rinjë: një (1) Inxhinier për SCADA dhe një (1) Praktikant – jurist. Kjo ka bërë që numri i përgjithshëm i punëtorëve në fund të tremujorit të tretë të jetë 369.

Gjatë periudhës tremujore Tetor-Dhjetor 2012 ka pasur lëvizje të punëtorëve për shkak të pensionimit të 2 (dy) punëtorëve, ndërsa 7 (shtatë) punëtorë të rinj kanë filluar punën në këto pozita:

- 5 (pesë) Operator NS 110 kV Gjilan 5
- 1 (një) Operator NS 110 kV Gjakovë
- 1 (një) Inxhinier -Praktikant

Viti 2012 është përmbyllur me 374 të punësuar.

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative aktuale e KOSTT-it.



Kryeshefi Ekzekutiv
Zyrtari i Auditimit të Brendshëm
Zëvendës i Kryeshefit Ekzekutiv për Operim
Zëvendës i Kryeshefit Ekzekutiv për Zhvillim
Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit
Sekretari i Kompanisë
Zyra e Komunikimit dhe Relacione me Publikun
Zyra e Zhvillimit dhe Planifikimit Afatgjatë

## 4.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

| Nr | Lënda nr. | Gjykata Kompetente | Paditës | I Padituri | Objekti i kontestit | Vlera e kontestit | Statusi | Statusi | Koment |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lënda Civile nr. 2248/03 | Gjykata Komunale në Prishtinë | Nuhi Çerkezi | KEK/ KOSTT | dëmshpërblim për lëndim në vendin e punës | 92,000.00 | Seanca me dt.23.03.2009. KOSTT ka kërkuar që lënda ti dërgohet KEK-ut për shkak të kompetencës | Seanca e caktuar për dt.14.07.2009, u mbajt me vonesë, KOSTT ia ka dorëzuar Përgjigjen në Padi Gjykatës dhe në seancë në tërësi hedh poshtë kërkesëpadinë e Paditësit si të pabazë.Pritet Aktgjykimi. | Seanca 01.04/11, shtyhet dhe seanca e dt.21.04 për dt.12.05/11.Gjykata pjesërisht aprovon kërkesë padinë në vlerë 5000€.Ankesa e KOSTT-it në shkallë të II-të. |
| 2 | Lënda penale nr.326/05 | Gjykata Komunale në Kaçanik | KOSTT | Nebih Bela, Veli Bela dhe Minir Mani | vjedhje | 2,370.00 | Seanca e rradhës u caktua për datën 18.11.2008; shtyhet 30.01;.shtyhet 30.03.2009 | Seanca e përfundimtare me dt.17.03/09, është mbajtë. Aktgjykimi.-është pranu, Lënda me Ankesë nga Prokurori të dt.08.04.2009. | Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer. Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë Ap.nr.321/2009, kthehet në Rigjykim të shk.I. |
| 3. | Lënda Civile nr.85/05 | Gjykata Komunale në Prishtinë | Ismajl Liman | KEK/ KOSTT | kompensim i dëmit | 50,000.00 | Seanca e rradhës është caktuar për datën 24.12.2008 | Seanca e rradhës është caktuar për dt.10.02.2009, Mbahet seanca përfundimtare me dt.11.06.2009. Refuzohet Kërkesëpadia e Paditësit. | Lënda me Ankesë në GjQ.Me Aktgjykimin Ac.1003/09, refuzohet Ankesa e palës. Lënda me Revizion në Gj.Supreme. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Lënda civile C1.nr.505 /07 | Gjykata Komunale në Prishtinë | Selvije Dedinca, bashkëshortja e të ndjerit Bashkim Dedinca, ish montator | KEK/ KOSTT | pagesa e kamatës ligjore | nuk ka | Përfaqësuesi i KEK-ut, ka refuzuar pjesëmarrjen në seanca pa prezencën e KOSTT-it. | Është caktuar seanca me dt.01.04.2009,shtyhet. KOSTT parashtron Ankesë ne GjQ-Pr, kundër Aktgjykimit C1 505/07. Seanca e rradhës, dt.06.05.2010. | Aktgjykimi nuk është i formës së prerë |
| 5 | Lënda penale nr. 2406/ 06 | Gjykata Komunale në Prishtinë | KOSTT | Ivica Filipoviq dhe Millorad Iliq | vjedhje | **15,398.00** | Aktgjykimi në favor të KOSTT-it por nuk është bërë akoma i plotfuqishëm | Verifikim me dt.11.06/09, Aktgjykimi nuk i është dorëzuar të paditurve, nga dt12.06, do t'i dorëzohet me polici | Miratim i pjesëshëm i Ankesës, Gjykata e Qarkut Pr.Propozim Ekzekutimi në afatin ligjor. |
| 6 | Lënda penale nr.320/06 | Gjykata Komunale në Kaçanik | KOSTT | Burim Krivanjeva | vjedhje e rëndë | **9,120.00** | Seanca e rradhës është caktuar për datën 14.11.2008 | Seanca e caktuar për dt.27.01.2009 është mbajtur dhe pritet Aktgjykimi | Aktgjykimi me Ankesë, në GjQ, nga dt.19.03/09 Verifikimi i fundit 29.06.2010. Aktgjykimi i GjQ-ankesa e aprovuar pjesërisht. |
| 7 | Lënda penale 284/06 | Gjykata Komunale në Lipjan | KOSTT | Avdullah Bejtullahu dhe Afrim Bejtullahu | vjedhje e rëndë | Nuk shtë përcakt-uar | KOSTT ka ushtruar Ankesën për zgjedhje të pjesërishme (vlera e kontestit) | | Lënda me Ankesë, pritet përgjigja nga Gjykata e Qarkut. |
| 8 | Lënda civile nr. | Gjykata Komunale | Hajrije dhe Milazim | KOSTT | Lirimi i banesës | nuk ka | Seanca e rradhës nuk | Seanca e caktuar gabimisht nga Gjykata | Seanca e rradhës nuk është caktuar ende. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 409/06 | në Prishtinë | Zeka | | Hajrije dhe Milazim Zeka | | është mbajturur, pritet caktimi i seancës tjetër | me dt.04.01/10 (ditë pushimi). | |
| 9 | Lënda civile nr.511/00 | Gjykata Komunale në Prishtinë | KOSTT | Fadil Hashani, Halil Selmanaj, Besnik Zhitia | lirimi i lokaleve në Kurriz | nuk ka | Kontesti ka përfunduar pozitivisht për KOSTT-in. Pritet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë | Aktgjykimi është marrë, në proces është propozimi për ekzekutim. | Ende nuk është kryer. (Paraprakisht marrëveshja me palët për lirim të Lokaleve). Lënda meAnkesë GjQPr. KOSTT, ka parashtruar Urgjencë GJQarkut-PR.Urgjenca e dytë 06/12 |
| 10 | Lënda civile nr. 2168/04 | Gjykata Komunale në Prishtinë | KEK dhe KOSTT | Kadri Rukovci | lirimi i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz | nuk ka | Seanca e rradhës u caktua për datën 19.11.2008 | Dalja në vend me Gjykatën, dt.23.04/09, pritet Raporti i Ekspertit. | Seanca e rradhës me dt.17.04/09, (Përfaqëson KEK-u). Pengohet puna e Ekspertit nga Pala. Njoftohet Gjykata. KOSTT parashtron Urgjencë në vazhdimin e çështjes GjK-Pr. |
| 11 | Lënda civile C.nr.588/08 | Gjykata Komunale në Gjakovë | Frrok Kaqinari | KEK-KOSTT | Kompenzim dëmi | **10000** | Seanca u caktua për dt.19.01.2009 | Seanca e rradhës në afat të pacaktuar | KOSTT, sipas Aktvendimit C.nr.136/09 paraqet përgjigje në Padi, me dt.28.04.2009. Në precizim të Padisë KOSTT me dt.27.03.2012, parashtron Përgjigje në Padi te C.nr.588/08 |
| 12 | C.156/09 | Gjykata Komunale Prizren | KOSTT | Qamil Kabashi | Kompenzim dëmi | | I parashtruar me dt.11.03/09. | | Pritet caktimi i seancës së rradhës. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **13** | Lëndë civile , Padi C.nr.190/ 09.e Lëndës P.nr 297/07; AP.359/0 4 | Gjykata Komunale Ferizaj | KOSTT | Asllan Krivanjeva | kompenzim i i dëmit | 200,00€ Aktvendi mi 600€ | Padia e dorëzuar në Gjykatë ,26.06/09 | Pritet caktimi i seancës. | Seanca e dt.17.12/12, me Aktvendim aprovohet Kërkesëpadia e KOSTT ne seancën e dt.08.01/13. |
| **14** | C.nr.1559 /06 | Gjykata Komunale Prishtinë | Selvije Dedinca | KOSTT | pagesa e Rentës. | | KEK ka paguar - Qershor/200 6. | Seanca e 06.05; 04.06, 08.07 dhe shtyhet 26.10/10 | KOSTT ka dhënë dëshminë mbi legjitimitet pasiv. |
| **15** | C.nr. 270/07 | Gjykata Komunale Podujevë | Mustafë Hasani etj | KOSTT | Kompenzi m dëmi | **100.000,€** | KOSTT- I padituri III-të (Tretë) | seancat e dt:10.09; dhe 12.10/10 dorëzimi i shkresave të lëndës KOSTT-it | Seanca e rradhës sipas ftesës se dt.05.11.2012, shtyhet 05.12/12, shtyhet dt.11.01/13 |
| **16** | A.nr.888/ 10 | Gjykata Supreme e Kosovës | KOSTT | KK Istog,- Bordit Komunal | Lartesia e Tatimit ne Prone-Peja 3 | **14.000€** | E paditur Komuna Istogut | Gjykata me Aktvendim Kontestin Administrativ e vlerson Sipas kerkeses se KOSTT-it. | Në këtë kontest KOSTT ka përfituar rreth 6000€ për çdo vit.Implementohet nga Komuna me dt.20.01/12 |
| **17** | C.nr.218/ 11 | Gjykata Komunale Ferizaj | Fevzi Nebihu | KOSTT/ Komuna e Feruzajit | Pengim Posedi | **500 €** | KOSTT- ka parashtrua Përgjigje në Padi sipas Aktvendimit të Gjykatës | Seanca e dt. 20.06/11, shtyhet me 04.07; shtyhet me 05.09/11.Seanca e rradhës dt.27.10/11 | Lënda e kryer në Shkallën e I-rë. KOSTT-parashtron Ankesë Gj.Qarkut-PR. |
| **18** | C.nr.503/ 11 | GJYKATA Komunale Pejë | KOSTT | AKP Pejë | Pengim Posedi | **nn** | Sipas Kërkesës së Gjykatës | Pritet ftesa për seancë(para seancës sqarime me Gjyqtarin) | Përsëritet Padia, Padi e re për Vërtetim Pronësie. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | KOSTT ka parashtrua precizimine Padisë. | | |
| 19 | C.nr.2255 /06 | GjK-Prishtinë | Xhemile Berisha | KOSTT | Kompenzim dëmi | nn | Sipas Kërkesës së të Atorizuarit të Paditëses me zgjerim të Padisë | Përgjigja në Padi sipas Akt. Gjyq.u dorëzua 12.11.2011. | Seanca Gjyqsore sipas ftesës. |
| 20 | A.nr.801/ 12 | Gjykata Supreme e Kosovës | KOSTT | AKP | Kompenzim dëmi | nn | Propozuesi KOSTT; Kundërpropozues AKP –Prishtinë. | Në marrëveshje me AKP stopohen vërejtjet për dorzimin e çelsave pas dorëzimin të Kërkesës, 27.06.12 | Seanca Gjyqsore 29.06/12, Refuzohet Propozimi A.nr.801/12 |
| 21 | Lënda Civile nr.116/2012/06 | Gjykata Komunale Kaçanik | Ahmet Luzha | KOSTT | Kompenzim dëmi | nn | Pritet ftesa për seancë | | |
| 22 | P.nr.65/2009 | Gjykata Komunale Vushtrri | KOSTT | Jakup Hasani | Aksident trafiku | nn | Kompenzimi i dëmit per Aksidentin e pësuar "Golf 5"-Sabri Musiqi. | Prokuroria Publike K.Mitrovicës në bazë te propozim akuzës ndaj shkaktarit të aksidentit Gjykata vendosë- | Shpall fajtor palën si në Aktgjykim sipas të cilit KOSTT-it i Kompenzohet dëmi. |
| 23 | C.nr.247/ 2012 | Gjykata Komunale Mitrovicë | Xhevdet Hasani | KOSTT | Masa e Përkohshme e Sigurisë | nn | Parashtrimi i Përgjigjes në Padi dhe Parashtresa | | Gjykata Anulon Masën e Sigurisë me Aktvendim 05.12/12 pranuar dt.13.12/12. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Kryetarit të Gjykatës dt.20.11/12; 6.12/12 | | |
| **24** | Aktgjyki mi C.nr.0574 /11 | GjK-Skenderaj | Shefqet Duli | KOSTT/ Komuna Skenderaj | Padi ndaj KK-Skenderaj | **116.800 euro** | Ekzekutimin e Aktgjykimit-KOSTT | Mbahet Seanca e datës 5. 12.2012. Parashtresë Gjykatës me dt 21.01.2013 | Seanca e radhës 5.02.2013 |
| **25** | Lënda Penale P.nr.255/ 05 | Gjykata Komunale Kaçanik | KOSTT | Atif Sopa dhe Begjet Bruti | Kompenzi m dëmi | **800.00** | | Propozim për ekzekutim me dt. 17.04.2009 | |
| **26** | E.nr.281/ 06 | Gjykata Komunale Lipjan | KOSTT | Momqillo Mitiq | Kompenzi m dëmi | 2176.5 | Propozim për ekzekutim më 11.07.2006 | Lënda vazhdon ne kompetencë të Gjyk. K. Prishtinë | |
| **27** | Lënda Penale P.nr. 174/07 | Gjykata Komunale Kaçanik | KOSTT | Mujedin Krasniqi dhe Nexho Axhami | Kompenzi m dëmi | **nn** | | | Parashtresë Gjykatës Komunale Kaçanik me dt. 18.01.2012 |

**Sqarim:**

- Lënda C.nr.503/11; C.nr.0571/11 dhe lënda C.nr.2255/06 janë lëndë të reja
- Lëndët e hijezuara janë lëndë të cilat janë të kryera deri në fund të vitit 2012

## 4.3. Kontratat/Transakcionet e konsiderueshme gjatë vitit 2012 nga burimet e KOSTT

| Nr | Departmenti | Lloji i Prokurimit | Nr i Proc. | Emri i Projektit | KONTRAKTORËT | Vlera e Kontratës | Vlera e Realizuar e Kontrates | Vlera e mbetur për realizim | % e Realizimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | Procedurë e Hapur | 21 | Sigurimi Shëndetësor i Punëtorëve | SIGAL | 556,800.00 € | 169,824.00 € | **386,976.00 €** | 30.50% |
| 2 | Deparamenti i OT | Procedurë e Hapur | 72 | Furnizim me Transformatorë te fuqise | Ballkan Petrol | 449,601.28 € | 67,440.19 € | **382,161.09 €** | 15.00% |
| 3 | Deparamenti i OT | Procedurë e Hapur | 11 | LOT 1: Furnizim me Kamiona | konz: AGS & PK | 391,461.00 € | 58,719.15 € | **332,741.85 €** | 15.00% |
| 4 | Deparamenti i OT | Procedurë e Hapur | 22 | Furnizim me Karburante për Automjete dhe Gjeneratora | Petrol Oti Slovenija | 350,000.00 € | 44,174.10 € | **305,825.90 €** | 12.62% |
| 5 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | Procedurë e Hapur | 58/1 1 | Furnizim me Softuer-Ftesa per Ofertim Nr1 | PPC IT | 290,687.12 € | 290,687.12 € | **- €** | 100.00 % |
| 6 | Deparamenti i OT | Procedurë e Negociuar Pa Publikim të Njoftimit të Kontratës | 9 | Rehabilitimi i NS Prishtina 3 | ENERGOINVEST | 253,900.00 € | 241,205.00 € | **12,695.00 €** | 95.00% |
| 7 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | Procedurë e Negociuar Pa Publikim të Njoftimit të Kontratës | 1 | Mirëmbajtja e CAS-it | KOMTEL PE | 240,000.00 € | 31,505.60 € | **208,494.40 €** | 13.13% |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Deparamenti i OT | Procedurë e Hapur | 48 | LOT 1: Furnizim Rezervë me një Ndërprerës 400kV i tipit GL 316 | UKAB | 183,454.00 € | 0.00 € | **183,454.00 €** | 0.00% |
| 9 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | Procedurë e Hapur | 64 | Shtruarja me prizma e trotoarit rreth Depos dhe Nenstacionit Kosova B | Rexha shpk | 174,008.35 € | 0.00 € | **174,008.35 €** | 0.00% |
| 10 | Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri | Procedurë e Hapur | 18 | Asfaltimi i Rruges se çasjes për në NS 400/110 kV Peja 3 | Lika Trade | 167,927.40 € | 167,927.40 € | **- €** | 100.00 % |
| | | | | | **TOTALI:** | **3,057,839.15 €** | **1,071,482.56 €** | **1,986,356.59 €** | **35.04%** |

**Spjegim:** Përqindja e realizimit prej 35.04 % paraqet përqindjen për dhjetë projekte më të mëdha .
Duke mos llogaritur kontratat kornizë për dhjetë projektet më të mëdha, përqindja e realizimit është 56.07 % .
Numri i projekteve të kontraktuara për vitin 2012 deri tani është 83.
Vlera e të gjitha kontratave te kontraktuara është : 4,505,168.43 €
Vlera e realizuar në përqindje deri tani është 43.55%

## 4.4. Sygjerime dhe propozime për rritjen e performancës

Në mënyrë që KOSTT të rritë edhe më tutje performancën, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- Vazhdimi i ngritjes së efiçiencës në mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmisionit
- Implementimit të projekteve kryesore që risin kapacitetet e operimit e që lidhen me operimin e mëvetësishëm të KOSTT;
- Vazhdimi i trajnimit të stafit që ritë shkathtësitë e tyre dhe efiçiencën e KOSTT;
- Vazhdimi i shqyrtimit të masave motivuese për stafin për ngritjen e kualitetit të punës së tyre.

## Lista e shkurtesave

AATC - (Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar (Import/Eksport)

AKP – Agjencioni Kosovar i Privatizimit

AIT – (Average interruption time) - koha mesatare e rënieve

ATC – (Available Transfer Capacity ) – Kapaciteti i disponueshëm

ATR – Autotransformatori

AUK – Universiteti Amerikan i Kosovës

BCU- ( Bay Controll Unit)- njësia kontrolluese

BD – Bordi i Drejtorëve

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

CGES- (crnogorski Elektro Sistem) – OST i Malit të Zi

CHF - Franga Zvicerane

DMS-(Documents Management System) – Sistemi për menaxhimin e dokumentacionit

ECLO – (European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

EJL – Evropa Juglindore

EKCS – Qendra Dispeçerike Emergjente

EMS- (Elektro Mreza Srbije) - Rrjeti Elektrik i Serbisë

ENS- (Energy not supplied)-Energjia e pafurnizuar

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

FAC- ( Final Acceptance Certificate) – Çertifikata e pranimit final

GSM –( Global System for Mobile Communication) – sistemi i përgjithshëm i komunikimit mobil

GJK – Gjykata Komunale

GjQ – Gjykata e Qarkut

HC - Hidrocentral

HMI – (Human Machine Interface) – ndërlidhja makinë-njeri

HVM- (High Voltage Metering) – matësi i energjisë

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

IPA- Instrumentet para anmtarësimit në Bashkimin Evropian

ITC – Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmisionit)

KA – Konflikt Administrativ

KCS - Qendra Dispeçerike Nacionale

KE – Kryeshefi Ekzekutiv

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

KQKO - Komiteti për Qeversje të Kodeve Teknike/Operacionale

LP – Largpërçuesi

MATC - Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planit Hapsionor

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NEF (Net Export Flow) – Eksporti i Kosovës

NIF - (Net Import Flow) – Importi neto për nevojat e Kosovës

NMS – (Network Management System) – Sistemi për menaxhimin e rrjetit

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OPGW – fibri optik

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

OT – Operatori i Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

PZhT – Plani Zhvillimor i Transmisionit

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managament System) -Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

SSE – Sistemi Elektro Energjetik

TC A – Termocentrali Kosova A

TC B – Termocentrali Kosova B

TCP/IP – (Transport Communication Protocol) –Internet protokole të komunikimit

TE- (Transmited energy)- Energjia e transmetuar

TKE- Traktati i Komunitetit të Energjisë

TI – Teknologjia e informacionit

TMR – Transformatori mtës i rrymës

TL – Tensioni i lartë

ToR (Terms of Reference) – Termat e Referencave

TP – Tatimi në pronë

TTC – (Total Transfer Capacity) – kapaciteti total i bartjes

USAID - (Unated States Agenci for International Development) – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)

USEA – ( US Energy Association)- Asociacioni Amerikan për Energji

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë